

EQD/EDNJ PËR DREJTORE



Ndërgjegjësimi

Kultura e të nxënësve në bashkëpunim mbështet kulturën e demokracisë

Përgatitja

Adresimi i sfidave

Veprimi

Shkolla juaj - një komunitet i të nxënësve

TË NXËNËT



Të nxënit

Shkollat bëjnë më shumë se vetëm t'u mësojnë nxënësve njohuritë dhe aftësitë. Shkolla është gjithashtu institucioni i parë në të cilin nxënësit hyjnë që në moshë të hershme dhe është një komunitet që jep mundësinë për shoqërim ndërmjet nxënësve, duke ndikuar shumë në qëndrimet dhe vlerat e tyre, sikurse edhe në ato të anëtarëve të stafit. Në shkollë, nxënësit e kalojnë pjesën më të madhe të kohës në klasë me mësuesit dhe shokët e shoqet e tyre. Prandaj, nëse ju, si drejtorë, dëshironi që shkolla juaj të bëhet më demokratike, është thelbësore që ta konsideroni atë që ndodh në klasë, duke përfshirë nxënësit dhe mësuesit.

Si drejtorë, ju duhet të qëndroni larg asaj çfarë mësuesit bëjnë në klasë. Madje, ka shtete ku drejtorëve nuk u lejohet të ndërhyjnë. Të shprehim se mësuesit tuaj janë mësuar të inkurajojnë nxënësit që të marrin pjesë në vendimmarrje dhe se ata marrin përgjegjësinë për të zhvilluar komunitetin e klasës dhe potencialin e nxënësve sa më mirë që është e mundur. Nga këndvështrimi i mësimdhënësve, përbën një dallim të madh nëse ata lihen vetëm në përpjekje të tilla, ose nëse e dinë se udhëheqësi i tyre i shkollës jo vetëm që e aprovon me vendosmëri qasjen e tyre demokratike, por është gjithashtu i gatshëm t'i mbështesë ata me të gjitha forcat e tij. Të nxënit lidhur me demokracinë në shkollë kërkon një qasje të gjithanshme shkollë, e cila përbën më shumë se shtimin e nismave në disa apo në të gjitha klasat. Mësimdhënësve u duhen mundësi për të shkëmbyer dhe reflektuar mbi përvojat e tyre, si dhe për të marrë informata dhe ide të reja. Me fjalë të tjera, një komunitet shkollor demokratik është një komunitet i të nxënit. Ky material ju ofron juve, drejtorëve, idetë dhe mjetet për të inicuar, bashkërenduar, kontribuar dhe mbështetur shkollën tuaj në rrugën e saj drejt demokracisë

Të nxënit

Të marrurit me të nxënit është pjesë e punës suaj. A është mësimdhënia pjesë e saj gjithashtu?

Shumë njerëz trokasin shpesh në derën e zyrës suaj, për udhëzime, këshilla dhe përgjigje. Nëse ka probleme, që zakonisht ndodhin shpesh, ju do të jeni ai që do t'i zgjidhni. Ju jeni përgjegjës për organizimin e shkollës. Ju doni të keni rezultate të mira. Ju e drejtoni shkollën, kështu që çdo gjë që bëni ka ndikim të madh në mësimdhënie dhe në të nxënë.

Ekzistojnë disa debate të fshehta ose të dukshme në lidhje me mësimdhënien në shkollë. Për shembull, a është mësimdhënia ngjarje e shenjtë që ndodh në klasë ekskluzivisht në fushën e mësuesve dhe nxënësve? A ka ndonjë lidhje të përbashkët ndërmjet lëndëve të ndryshme, veçanërisht atyre që merren me shkencën, me edukimin e orientuar në vlera apo edukimin fizik? A ka ndonjë lidhje midis punës që bëhet në klasë, në laborator ose në oborrin e shkollës? A nuk duhet që drejtori i shkollës të merret me punën e tij administrative dhe t'ia lë mësimdhënien specialistëve?

Pavarësisht nga fakti që pothuajse në mbarë botën ligjet dhe rregulloret e shkollave kërkojnë qëllime mësimore të gjalla demokratike, si dhe pavarësisht nga evolucioni i pedagogjisë dhe didaktikës që përshkruajnë rrugën nga mësimdhënia autoritare në të nxënit në bashkëpunim, në shkollat e sotme mund të gjendet shumëllojshmëri e praktikave të mësimdhënies, duke filluar nga të besuarit se mësimdhënia është transmetim i njohurive e deri te të pranuarit se është proces shumëdimensional.

Megjithatë, në qoftë se demokracia duhet të mësohet, ajo duhet jo vetëm të dihet në mënyrë kognitive, por edhe të provohet dhe të përjetohet. Kështu, koha e mësimdhënies, që përfshin shumicën e kohës së kaluar në shkollë, është një agjent thelbësor, dhe roli i drejtorit në këtë drejtim është vendimtar.



Të nxënit

Çfarë, pse, për çfarë dhe si mësojmë të ndikojmë në mënyrën se si qytetarët e shohin veten në një shoqëri?

Shkolla është vendi ku nxënësit përgatiten për rolet e tyre si qytetarë dhe vendimmarrës në jetën e tyre prej të rriturve. Për më tepër, shkolla është më shumë se një vend ku nxënësit përgatiten për jetën – shkolla është jeta. Ndërsa edukatorët dhe nxënësit e pranojnë këtë fakt, drejtori duhet të përqafojë sfidën e udhëheqjes nëpër këtë rrugë.

Çështja se çfarë, pse, për çfarë dhe si mësojmë, nuk duhet të merret me lehtësi. Ajo është çështja kryesore së cilës profesionistët dhe praktikuesit e mësimdhënies duhet t'i përgjigjen sa herë që mendojnë se si t'u shërbejnë më së miri nxënësve të tyre. Kjo ju udhëheq juve si drejtor i shkollës dhe veçanërisht ata mësues që i vënë vetes qëllimin që të gjithë nxënësit të arrijnë rezultatet më të mira të mundshme, që të përvetësoni një qasje me nxënësit në qendër. Çfarë do të thotë kjo?

Kutia e dhuratës, e mbështjellur

Në fillim të vitit shkollor, secili mësues, në duart e tij apo saj, mban një kuti dhurate të mbështjellur. Përmbajtjet e saj janë përshkruar si kurrikula apo edhe tekstet shkollore që do t'u ofrohen nxënësve dhe që do të mësohen në një nivel të caktuar. Në një masë më të vogël, kutia e dhuratave përmban pjesë të shkencës. Ministria e arsimit ose autoritetet lokale kanë bashkuar përmbajtjen themelore. I mbetet mësuesit të vendosë se si ta përgatisë këtë kuti, si t'ua paraqesë atë nxënësve me udhëzime pas hapjes së saj. Megjithëse përmbajtjet mund të jenë e njëjta, mësuesit mund të gjejnë shumë mënyra për t'i rregulluar ato në kuti. Ata gjithashtu mund të improvizojnë se çfarë dhe si të korrigjojnë nga përmbajtja, si ta mbështjellin dhe ta dekorojnë, si t'ua japin atë nxënësve me sugjerimet për mënyrat e hapjes së saj. Edhe në qoftë se kjo procedurë, që i përket procesit të mësimdhënies dhe të nxënit, përsëritet çdo vit, ka aq shumë mënyra të ndryshme për çdo hap, sa që ndërveprimi ndërmjet nxënësve dhe mësuesve mund të provohet si i ri dhe i ndryshëm çdo herë.

Çfarë e përbën një kuti dhurate?

Një kuti e mbështjellur është interesante në vetvete dhe është edhe më interesante nëse mbështjellja e saj i bën përshtypje marrësit. Kur përzgjedh një dhuratë, njeriu ose e ka në mendje interesin e vet, ose të marrësit. Varësisht se çka ka zgjedhur dhuruesi, një kuti dhurate e mbështjellur mund të jetë kënaqësi ose fatkeqësi. Mësuesit kanë të gjitha mjetet në dorë për t'u siguruar që kjo dhuratë të jetë sukses. Ata e zotërojnë shkencën e tyre dhe përmes përvojës ata dinë shumë për nevojat dhe interesat e nxënësve. Kurioziteti është karakteristikë e natyrshme e njerëzimit. Ne i detyrohemi kuriozitetit për evolucionin e qytetërimit. Nëse mësuesit kanë sukses në paraqitjen e lëndës së tyre si një objekt që duhet zbuluar ose çmbështjellur, dhe nëse po ashtu arrijnë të ngjallin kuriozitet rreth saj, ata do t'i ndihmojnë nxënësit t'i shpiejnë interesat e tyre përtej çështjeve të tyre personale dhe të zgjerojnë horizontin e tyre në kërkim përtej sferës së tyre personale të jetës.



Çfarë lloj hapësi i kutisë së dhuratave jeni?

Pavarësisht nëse një kuti dhurate hapet vetëm ose së bashku me të tjerët, ka disa mënyra për të përdorur një objekt krejt të ri. Disa kanë nevojë për doracak përpara se ta prekin, ndërsa të tjerët janë të gatshëm t'i pranojnë pikëpamjet dhe sugjerimet e kujtdo që ndodhet pranë. Një grup i tretë, që nuk ka nevojë për asnjërën nga këto më sipër, merr ca kohë për të parë, prekur dhe eksperimentuar vetë. Në të gjitha situatat, e gjithë kjo ngjarje përfshin të paktën dy persona, dhënësin dhe marrësin, por ajo ka ndikim në një numër më të madh njerëzish përreth. Në të vërtetë, është diçka si flutura që i përplas krahët e saj diku në jug dhe tornadoja tërbohet larg në veri. Është një konstruksion shoqëror. Kompetencat janë të nevojshme për ta shfrytëzuar mirë paketën, duke përfshirë ca njohuri për përmbajtjet, të kuptuarit e karakteristikave të tyre, por edhe metodat dhe aftësitë për t'i paraqitur dhe diskutuar ato, ashtu sikurse edhe një qëndrim përgjegjësie që çpaketimi, pronësia dhe përdorimi i përmbajtjeve mund të krijojë.

Është interesante se përmbajtjet mund të jetë të ndryshme, por procesi i trajtimit është në thelb i ngjashëm. Ajo që është më interesante është se ky proces është vendimtar për vetëvlerësimin dhe rolin e nxënësve si qytetarë në një shoqëri. Ajo që është edhe më interesante është se drejtori i shkollës është ai që e bën gjithë këtë krenim, sepse ka të bëjë me profesionin e të gjithë mësuesve, pavarësisht nga profilet e tyre specifike.

Të nxënit

Mësimdhënia e demokracisë dhe të drejtave të njeriut si një qasje tërëshkolllore

Pozicioni i drejtorit mund të ndryshojë shumë nga një vend në tjetrin, por mënyra se si njerëzit mësojnë më së miri mbetet e njëjtë. Bashkëpunimi dhe të mësuarit e ndërsjellë, p.sh. mësuesit që mësojnë nga mësuesit, jo vetëm që përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënit në shkollën tuaj, por edhe burimet e zhvillimit të shkollës. Ky proces varet nga vendimi juaj për ta filluar atë së bashku me mësuesit tuaj dhe për ta organizuar dhe mbështetur atë.

Komunitetet demokratike mbështeten në qytetarët e edukuar

Shoqëritë tona gjithnjë e më komplekse dhe dinamike e kërkojnë Edukimin për Qytetari Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (EQD / EDNJ) si sfond të përbashkët të çdo aktiviteti mësimor në shkollë, si në klasë ashtu edhe përtej saj. Niveli i arsimimit që nxënësve u duhet sot tejkalon në masë aftësinë e thjeshtë për të lexuar, logaritur dhe shkruar. Më tepër, arsimimi për të cilin nxënësit kanë nevojë sot përfshin:

- të kuptuarit më të mirë të botës;
- të menduarit logjik, kritik dhe kreativ;
- aftësinë për ta lidhur abstrakten me konkretin;
- aftësinë për t'i kuptuar konceptet dhe simbolet abstrakte;
- aftësinë për t'i interpretuar faktet dhe të gjeturat e hulumtimit;
- aftësinë për të mësuar në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim;
- shkurt, të arsimohen në mënyrë funksionale.

Komunitetet demokratike mbështeten në qytetarët e edukuar dhe kompetentë. EQD / EDNJ i trajton të gjitha kompetencat e përmendura më lart dhe i pasuron ato me vlerat dhe qëndrimet që e përbëjnë kulturën e demokracisë. Shih [Kompetencat për Kulturë Demokratike](#).

EQD/EDNJ si qasje tërëshkolllore

Shkrim-leximi zgjerohet dhe ndërton ura në mes kufijve të fushave të specializuara të shkencës dhe dijes. Për më tepër, krijon një bazë të përbashkët që plotëson fushëveprimet dhe qëllimet e çdo lënde akademike, e cila i përgatit nxënësit më mirë për sfidat sot dhe në të ardhmen. EQD / EDNJ u përgjigjet disa prej çështjeve urgjente të diskutueshme të shoqërive tona dhe ofron një koncept të tillë të shkrim-leximit për një qasje ndërkurrikulare dhe tërëshkolllore. Në nivel të lëndëve shkollore, mësimdhënia dhe të nxënit nuk duhet të riformulohen ose ristrukturohen. Më tepër, ato duhet të integrohen në një perspektivë më të gjerë, duke i bërë ato bashkë si pjesë të një tërësie. Çdo lëndë fokusohet në përmbajtje specifike në kurrikulë, dhe në metodat dhe mënyrat specifike të arsimit që ato përmbajtje dhe tema kërkojnë. Nga perspektiva e tërë shkollës, lëndët shkollore mund të konceptohen si kor. Çdo zë është qartë i dëgjueshëm, por kori në tërësi këndon të njëjtën pjesë, që do të thotë se shkolla në tërësi i ka të njëjtat qëllime arsimore.



Prapavija e përbashkët

Qasja tërëshkollore në mësimdhënie i inkurajon mësuesit që të punojnë drejt një grupi të vetëm në komunitetin e shkollës, pasi që mësimdhënia e tyre, pa marrë parasysh sa të ndryshme janë lëndët e tyre mësimore, ndan qëllime, nevoja dhe sfida të caktuara. Të gjithë mësuesit u shërbejnë nxënësve të të njëjtës grupmohë dhe përballen me të njëjtin diversitet mes tyre, për shembull në kapacitetin e tyre të të mësuarit. Për më tepër, përvetësimi i kulturës së demokracisë po ashtu është detyrë për të gjithë shkollën.

Rrjedhimisht, në edukimin për demokracinë dhe të drejtat e njeriut, shkollat kanë nevojë për një qasje të mësimdhënies ndërkurrikulare për t'u dhënë nxënësve njohuri dhe të kuptuar të demokracisë dhe të drejtave të njeriut, si dhe praktikimin e aftësive, dhe për t'ua mësuar qëndrimet dhe vlerat që qytetarëve u duhen për të marrë pjesë dhe mbështetur demokracinë. Kjo mënyrë kohezive, kolektive dhe bashkëpunuese e mësimdhënies gjithashtu përfshin punonjësit e shkollës, prindërit dhe komunitetin lokal. Për më tepër, kjo qasje e pasuron dhe e forcon mësimdhënien si parimin bazë të jetës shkollore në klasë, në oborrin e shkollës e në menzë, dhe madje edhe përtej mjediseve të shkollës. Nuk ka asnjë shkencë akademike apo lëndë që mund të shkarkohet nga barra e të shërbyerit asaj nevoje arsimore.

Të nxënit

Shkolla si komunitet i të nxënit

Diskutime dhe zhvillime të reja ndodhin gjithnjë në arsim. Përderisa është e pamundur që cilido drejtor të jetë i vetëdijshëm për çdo gjë, disa mësues në shkollën tuaj mund të kenë informata relevante për të dhënë. A janë këto çështje në arsim të rëndësishme për shkollën tonë? Si mund ta dimë? A mund ta përdorim më mirë kohën para dhe pas mësimit?

Sistemi i qëndrueshëm

Në çdo komunitet të shkollës, mësuesit plaken më shumë se njerëzit e tjerë. Nxënësit janë gjithmonë të të njëjtës moshë, dhe shumica e prindërve i përkasin të njëjtës grup moshe, me përjashtime të vogla. Kështu, radhët e profesionistëve të mësimdhënies në një shkollë kanë nevojë për rimbushje dhe përtëritje për t'i kundërvepruar prirjes, në mënyrë që të mos zgjerohet hendeku i moshës i krijuar nga vitet. Shkolla është vend i inovacionit, por shumë mësues përjetojnë zhgënjimin e ndryshimeve të sistemit që vijnë dhe shkojnë. Ajo që nevojitet është një sistem i qëndrueshëm që e bën çdo ditë të këndshme përtej punës së bërë, që ofron përbushje dhe lumturi dhe ruan argëtimin. Demokracia është çështje aq serioze sa që nuk mund të mbijetojë pa një sistem të tillë të qëndrueshëm.


Mësimdhënësit duhet të jenë në gjendje ta kuptojnë shkollën si një komunitet i të nxënit dhe si një komunitet ku të nxënit praktikohet. Një komunitet i të nxënit është i vetëdijshëm se bashkëpunimi jo vetëm që përmirëson performancën akademike, por edhe i ndihmon anëtarët e komunitetit të zhvillojnë vetëdije dhe vetëbesim. Bëhet fjalë për krijimin e një pjesëmarrjeje dinamike e kompetente përmes praktikës.

Dy elemente themelore

Sa i përket mësimdhënies, një komunitet i të nxënit varet nga dy elemente themelore: lidhja e mësimdhënies me të nxënit dhe krijimi i një kulture bashkëpunimi për këtë qëllim.

Lidhja e mësimdhënies me të nxënit

Le të marrim një shembull të zakonshëm: Një mësues e zhvillon një njësi mësimore më së miri që mundet. Disa nga nxënësit e kanë zotëruar atë njësi, disa kanë pyetje dhe të tjerët kanë nevojë për më shumë ndihmë dhe vëmendje. Këtu lindin dy nevoja të ndryshme: mësimdhënësi duhet të ndjekë kërkesat e kurrikulës dhe të kalojë në çështjen tjetër, ndërkohë që disa nga nxënësit kanë nevojë për më shumë kohë për ta kuptuar atë njësi mësimore. Nuk ka kohë të mjaftueshme për të dyjat. Një komunitet i të nxënit krijon një gamë më të gjerë të mundësive për të kapërcyer një dilemë të tillë duke pasur parasysh që të gjithë mësuesit kujdesen për nevojat individuale të çdo nxënësi veç e veç.



Pasi që ekziston e drejta në arsim, shkolla është e detyruar të ofrojë mundësi të barabarta të të nxënësve dhe mësimdhënies e planifikuar duhet t'i ndihmojë të gjithë nxënësit për të arritur qëllimet e tyre të të nxënësve. Prandaj, nuk mjafton për nxënësit që t'u ligjërohet, por duhet të sigurohemi që ata të nxënësve. Pa marrë parasysh se sa e thjeshtë kjo tingëllon, është një zhvendosje e vështirë nga zakonet e mësimdhënies tradicionale. Kjo do të thotë se duhet të ketë një hulumtim të praktikave që mund të sigurojnë barazinë e mundësive të të nxënësve, pa marrë parasysh se sa të ndryshme mund të jenë karakteristikat e mësuesve ose të nxënësve. Rezultatet e këtij hulumtimi duhet të studiohen për të dhënë tregues të përshtatshëm ku përkthehen hapat e nevojshëm dhe vlerësimi i tyre.

Krijimi i kulturës së bashkëpunimit

Që mësuesit të veprojnë si një komunitet i të nxënësve, ata duhet të jenë të lidhur së bashku nga një kulturë bashkëpunimi. Nëse çdo arritje e veçantë e nxënësve është një qëllim i përbashkët, atëherë çdo mësues mund të kontribuojë në të nga një perspektivë e ndryshme, ofruar qoftë nga lënda mësimore e ndryshme që e jep, ose nga metodat dhe strategjitë e ndryshme të mësimdhënies që ai/ajo përdor. Rrjedhimisht, bashkëpunimi i mësuesve nuk mund të kufizohet vetëm nga çështjet tradicionale në lidhje me programin, aktivitetet ose disiplinën e shkollës, por duhet të përqendrohet në kujdesin për nevojat e secilit nxënës. Kjo kërkon të punuarit së bashku, të diskutuarit dhe të analizuarit e praktikave të mësimdhënies dhe vendime të përbashkëta për të sjellë përmirësime në çështjet profesionale, shkencore, pedagogjike ose didaktike. Ky lloj bashkëpunimi kërkon dhe inkurajon zhvillimin e aftësive të bashkëpunimit që qytetarëve gjithashtu u duhen për pjesëmarrje demokratike, p.sh. "identifikimi dhe caktimi i qëllimeve të grupit" dhe "ndarja e njohurisë, përvojës ose ekspertizës relevante dhe të dobishme me grupin dhe bindja e anëtarëve të tjerë të grupit për ta bërë këtë". Shihni [Kompetencat për Kulturë Demokratike](#), fq. 49.

Të nxënit

Kultura e të nxënit

Si drejtor, ju nuk mund të impononi një kulturë të të nxënit në shkollën tuaj, por shembulli të cilin e jepni dhe angazhimi juaj janë vendimtare. Prandaj, zgjedhja që bëni është një nga vendimet më të rëndësishme që duhet të marrë një drejtor: Çfarë lloj kulture të të nxënit dëshironi që shkolla juaj të përvetësojë? A janë mësuesit tuaj në përgjithësi të vetëdijshëm se nxënësit duhet të jenë të përfshirë në procesin e tyre të të nxënit dhe se metodat bashkëpunuese të mësimdhënies dhe të të nxënit i inkurajojnë ata që të qasen në mënyrë kritike dhe të interesohen për të gjitha dimensionet e mundshme të një teme, duke i ftuar ata që të diskutojnë dhe të mos pajtohen, të formojnë opinionet e tyre, t'i argumentojnë, negociojnë dhe madje edhe t'i ndryshojnë ato. Një kulturë e tillë e të nxënit nuk është luks, sikur nuk është luks as mësimdhënia e mirë dhe as edukimi për demokracinë dhe të drejtat e njeriut.

Për më tepër, një kulturë e tillë e të nxënit jo vetëm që u shërben nxënësve tuaj, por po ashtu ka shumë të përbashkëta me kulturën e demokracisë. Mund ta konceptojmë shkollën si një mikrokomunitet që u ofron të rinjve mundësi të marrin përgjegjësi për çështjet në jetën shkollore dhe të përjetojnë proceset e vendimmarrjes gjatë trajtimit të tyre. Komunitetet demokratike, si në nivelin mikro ashtu edhe në atë makro, janë komunitete të të nxënit, pasi asnjë palë nuk mund ta definojë e vetme, të mirën e përbashkët. Shumicat vendosin, por vendimet e tyre mund të mos e zgjidhin problemin ose mund të jenë të padrejta. Një komunitet i të nxënit mund të nxjerrë përfundime nga këto vendime dhe t'i korrigjojë ato.

Si mundet mësimdhënia t'i inkurajojë dhe t'ua mundësojë nxënësve të marrin pjesë aktivisht në shoqëritë e tyre?

Metoda shkencore

Shqyrtimi dhe arsyetimi janë të pamundura nëse nxënësit nuk janë të interesuar. Në didaktikë pranohet se thelbi i të nxënit është motivimi. Nxënësit duhet të jenë në gjendje ta lidhin çështjen në fjalë me njohuritë e tyre ekzistuese dhe ajo duhet të jetë në përputhje me interesimin e tyre. Të dyja, njohuritë dhe interesimi, duhet të kultivohen në procesin e të nxënit. Në eksplorimin e botës, "metoda shkencore" ka evoluar. Është një proces hap pas hapi që përfshin vëzhgimin, pyetjen, hipotezën, eksperimentin, analizën, përfundimin dhe fillimin nga e para përsëri. Shqyrtimi dhe arsyetimi në mësimdhënie kërkon që mësuesit të marrin në konsideratë karakteristikat, interesimin dhe nevojat e nxënësve gjatë planifikimit ose mbajtjes së njësive të tyre. Duke ua bërë të mundur nxënësve për ta zotëruar procesin e kërkimit shkencor jepet përgjigjja më mirë e mundshme për "Pse-të" e mësimdhënies.



Të jetuarit së bashku
si të barabartë në
shoqëritë
demokratike,
kulturalisht të
larmishme

Qasja me kujdes

Elementi kryesor i qytetarisë demokratike është ajo që ne e quajmë “qasje kritike”. Është një proces që ndjek hapat e metodës shkencore. Ajo kërkon që qytetari të jetë i interesuar për të mirën e përbashkët dhe të jetë i njohur me metodën e mbledhjes së informacionit mbi aspekte të ndryshme përpara se të formojë një opinion mbi një çështje. Nxënësit mund të trajnohen në të menduarit dhe të gjykuarit kritik në shkollë, duke kërkuar një qasje tërëshkollore në emër të mësuesve. Nxënësit kanë nevojë për shumë detyra dhe mundësi të të mësuarit përmes lëndëve mësimore në kurrikulë. Mësimdhënia e mirë mbivendoset fuqishëm me EQD/EDNJ. Modeli i Këshillit të Evropës i kompetencave për kulturën demokratike përfshin aftësitë që po ashtu mbështeten në metodën shkencore “të të nxënësve të pavarur” dhe “të të menduarit analitik dhe kritik”. Shih [Kompetencat për Kulturë Demokratike](#) fq. 43-44.

Mjedisi i të nxënësve

Në shkollë, klasat janë komunitete të vogla ku qytetarët e rinj mund të fuqizohen dhe të inkurajohen të luajnë rol aktiv. Mësimdhënia mund t'i pajisë të rinjtë me aftësitë themelore që u duhen për t'i zhvilluar kompetencat e tyre në kërkimin shkencor, të menduarit kritik, pjesëmarrjen dhe vendimmarrjen. Nxënësit që e kanë pasuruar përvojën e tyre në mënyra të tilla të të nxënësve, janë të përgatitur mirë për t'u bërë qytetarë demokratikë dhe pjesëmarrës aktivë.

Ju nuk jeni vetëm

Ndoshta kjo perspektivë për rolin tuaj si drejtor në zhvillimin e një kulture të të nxënësve në shkollën tuaj duket e panjohur dhe detyrat që priten nga ju duken mjaft frikësuese. Ne jemi plotësisht të vetëdijshëm për gamën e detyrave dhe përgjegjësisë në duart tuaja dhe se sa kohë duhet t'u kushtoni detyrimeve tuaja ligjore. Megjithatë, mund t'ju sigurojmë se nuk jeni vetëm. Këshilli i Evropës ka një histori të gjatë të promovimit dhe zhvillimit të Edukimit për Qytetari Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (EQD/EDNJ), në një proces të vazhdueshëm në të cilin janë të përfshirë drejtorët nga shkollat në gjithë Evropën. Nëse dëshironi të mësoni më shumë për historinë e EQD/EDNJ, vizitoni <https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-1/part-1/unit-4/> në këtë ueb faqe.

Të nxënit

Edukimi për vlerat inkurajon vetëdisiplinën e nxënësve

Ju jeni duke ecur përgjatë korridorit në shkollë. Zhurma që vjen nga një klasë ju tregon se ora mësimore ka dalë jashtë kontrollit dhe mësuesi nuk është në gjendje ta përballojë situatën. Gjatë ose menjëherë pas orës, mësuesi troket në derën tuaj dhe ju kërkon që të ndërhyni. Nxënësit të cilët mësuesi i ka identifikuar si telashexhinj do të deklarohen të pafajshëm, duke ju vënë në një pozitë të pakëndshme të një “gjyqtari të lartë”. Në incidente të tilla, mësuesi do të humbë respektin e nxënësve.

Ky skenar tregon për dobësinë e stilit autoritar të udhëheqjes së shkollës: nxënësit duhet t’u binden rregullave të vendosura dhe, nëse nuk u binden, mësuesi duhet t’i zbatojë ato me detyrim. Kjo i bën mësuesit të ndihen në siklet, duke u përballur me një shumicë të madhe të telashexhinjëve dhe armiqve të mundshëm në klasë. Kontrolli i përhershëm, lavdërimi dhe ndëshkimi janë mjetet në duart e mësuesve për të zbatuar rendin dhe disiplinën.

Disiplina e nxënësve është me të vërtetë thelbësore që një shkollë të funksionojë mirë. Për më tepër, shkolla është institucioni i parë në jetën e tyre ku fëmijët dhe të rinjtë hyjnë, dhe këtu nxënësit duhet të mësojnë t’i binden ligjit, jo sepse janë të detyruar, por sepse duhet ta kuptojnë dhe ta vlerësojnë domosdoshmërinë e sundimit të ligjit. Mirëpo, një sistem i mbikëqyrjes dhe sanksioneve të përhershme nuk është as i realizueshëm e as i dëshirueshëm, pasi një shkollë e tillë ua mëson nxënësve një qëndrim bindjeje, duke i lënë ata të paafhtë për ta marrë përgjegjësinë për komunitetin e shkollës.

Vlerat janë të padukshme, por ato shfaqen në sjelljen e një personi. Në një masë të madhe, disiplina nuk mund të imponohet, por duhet të rritet nga brenda. Vlerat nuk mund të predikohen, por duhet të mësohen nga shembujt e mirë. Si model që jeni, qëndrimi juaj dhe i stafit tuaj është vendimtar për zhvillimin e një komuniteti shkollor demokratik, të bazuar në vlera.

Nëse i pyetni nxënësit se çfarë presin nga shkolla, përgjigjet e tyre tregojnë se ata shpesh presin më shumë se sa ç’mund t’u japë shkolla. Ata duan ta shpenzojnë kohën e tyre mirë dhe duan që shkolla e tyre të funksionojë si duhet, edhe pse sjellja e tyre nganjëherë mund të jetë problematike. Prandaj, është e mundshme t’i bindim nxënësit se asnjë komunitet nuk mund të funksionojë pa rregulla, dhe se kjo vlen edhe për komunitetet demokratike. Shih “Të rishikojmë disiplinën dhe rregullin nga një pikëpamje demokratike” <https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-1/part-2/unit-1/chapter-2/lesson-5/>.



Nëse nxënësit i ndajnë vlerat që nxiten nga rregullat e shkollës, ata do të jenë të gatshëm t'i pranojnë dhe t'i çmojnë ato. Në Kompetencat për kulturë demokratike, të publikuara nga Këshilli i Evropës, këto vlera përfshijnë “mbështetjen për sundimin e ligjit dhe trajtimin e barabartë dhe të paanshëm të të gjithë qytetarëve para ligjit, si mjet për të siguruar drejtësinë”. (*Kompetencat për Kulturë Demokratike*, fq. 38, nr. 7).

Rregullat e bazuara në vlerë duhet të diskutohen dhe komunikohen në klasë, e këtu, EQD/EDNJ luan një rol të rëndësishëm. “Rritemi në demokraci”, vëllimi II në serinë e manualëve të EQD/EDNJ për mësuesit, përshkruan një projekt të vogël në të cilin nxënësit vlerësojnë rregullat ekzistuese të shkollës, identifikojnë vlerat dhe parimet themelore dhe diskutojnë sugjerimet për t'i rishikuar dhe përmirësuar rregullat. Pamja e kopertinës së këtij vëllimi, që tregon nxënësit duke nënshkruar rregullat e shkollës që i kanë miratuar me shumicë votash, nxjerr në pah potencialin e të nxënësve të këtij projekti, pasi u lejon nxënësve të marrin pjesë në vendimmarrjen në shkollë. Çështja është kuptimplote dhe një pjesë e vërtetë e jetës reale në shkollë. Edukimi për qytetarinë demokratike dhe për vlerat e kulturës demokratike është i mundur me të gjitha grupmoshat. “Rritemi në demokraci” u dedikohet mësuesve në nivelin fillor, ashtu që projekti për pjesëmarrje në vendimmarrje në shkollë të mund të përshtatet për nxënësit më të vjetër. <https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-2/unit-5/>.


Nxënësit janë plotësisht të vetëdijshëm se sjellja e tyre duhet të monitorohet dhe se rregullat do të zbatohen nëse ato thyhen. Kjo mbetet përgjegjësi e drejtorit dhe e stafit, në përputhje me legjislacionin e shkollës. Ata nxënës që e kanë zhvilluar një qëndrim të mendësisë qytetare, “një ndjenjë të llogaridhënies ndaj njerëzve të tjerë brenda komunitetit dhe pranim se njëri i përgjigjet të tjerëve për vendimet dhe veprimet e veta” (*Kompetencat për Kulturë Demokratike*, fq. 41), do të krijojnë më pak çështje disiplinore, pasi ata e kanë zhvilluar vetëdisiplinën dhe mund të marrin përgjegjësi për sjelljen e tyre.

Të nxënit

Kompetencat për kulturë demokratike: një diagram

Burimi: Shih [Kompetencat për Kulturë Demokratike](#)

Figurat nr. 1 – 7 i referohen shënimeve



Diagrami i kompetencave për kulturë demokratike: shënime

Numri i faqeve i referohet dokumentit [Kompetencat për Kulturë Demokratike](#)

Ky diagram është një përpjekje për ta bërë të dukshëm modelin konceptual të kompetencave që qytetarët duhet t'i krijojnë dhe të marrin pjesë, në një kulturë të demokracisë (shih fq. 9). Modeli është dizajnuar që t'i ngjajë realitetit në një mënyrë të thjeshtuar, duke u përqendruar në disa aspekte kryesore dhe duke lënë jashtë shumë të tjera. Një hartë rrugore, për shembull, është një model i rrjetit rrugor në një zonë të caktuar, e cila është e dobishme sepse tregon shumë pak gjëra të tjera. Ngjashëm, modeli i kompetencave për kulturën demokratike shërben si një hartë. Ai tregon se si sjellja jonë si individë është e lidhur me kulturën demokratike në tërësi dhe se si shkollat mund të luajnë rolin e tyre në edukimin e nxënësve të tyre për qytetari demokratike.

Diagrami dhe shënimet e mëposhtme synojnë të ndihmojnë lexuesit e manualit Kompetencat për Kulturë Demokratike, por nuk e zëvendësojnë atë. Ato janë të destinuara për trajnime në shërbim të mësuesve dhe drejtorëve, ose informacion për prindërit dhe palët e jashtme.

1. Kuadri institucional i demokracisë (sistemi politik) nuk mund të funksionojë ose të mbijetojë nëse nuk mbështetet nga një kulturë e demokracisë që të gjithë qytetarët ndajnë. Në një kulturë të tillë të demokracisë, qytetarët janë të përkushtuar për të respektuar sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut dhe për të zgjidhur çështjet e interesit të përgjithshëm për publikun. Ata janë të bindur se konfliktet duhet të zgjidhen në mënyrë paqësore dhe ata pranojnë dhe respektojnë diversitetin në shoqëri. Qytetarët janë të gatshëm të shprehin mendimet e tyre, si dhe të dëgjojnë mendimet e të tjerëve. Ata janë të përkushtuar ndaj procesit vendimmarrës të bazuar në shumicën e votave, si dhe në mbrojtjen e pakicave dhe të drejtave të tyre. Ata janë të gatshëm të angazhohen në dialog rreth barrierave kulturore (shih fq. 15). Strukturat institucionale të demokracisë dhe kultura e demokracisë janë “qenësisht të ndërvarura” (fq.15), që do të thotë që asnjëra fushë nuk është e vetëqëndrueshme nëse nuk mbështetet nga tjetra. Fuqia e kulturës së demokracisë varet jo vetëm nga qytetarët kompetentë, por gjithashtu edhe nga fakti se deri në çfarë mase elementet kryesore të përmendura më sipër janë të ndara mes qytetarëve dhe jo të kontestuara apo të diskutueshme (shih shënimin 6).
2. Kur qytetarët marrin pjesë në diskutime dhe në marrjen e vendimeve, ata takojnë të tjerët, prejardhja kulturore e të cilëve është e ndryshme. Prandaj, dialogu ndërkulturor midis qytetarëve është shenjë dalluese e shoqërive demokratike kulturalisht diverse. Qytetarët të cilët janë të gatshëm të angazhohen në dialog rreth tjetërsive kulturore e trajtojnë njëri-tjetrin si të barabartë demokratikisht. Dialogu ndërkulturor duhet të jetë i ngulitur në kulturën e demokracisë, dhe anasjelltas, një kulturë demokratike nuk mund të lulëzojë pa dialog ndërkulturor. Kultura demokratike dhe dialogu ndërkulturor janë “qenësisht të ndërvarura” (fq.15), duke lidhur nivelin makro të shoqërisë me nivelin mikro të ndërveprimit midis individëve. Kjo ide është përmbledhur në logon e kësaj faqeje interneti, Demokracia në veprim.
3. Qytetarët kompetentë janë një parakusht i domosdoshëm për kulturën demokratike dhe dialogun ndërkulturor, por vetëm kompetencat nuk janë të mjaftueshme. Efekti i institucioneve politike në nivelin makro është thelbësor: “... në varësi të konfigurimit të tyre, aranzhimet institucionale mund të mundësojnë, kanalizojnë, frenojnë ose pengojnë mënyrat në të cilat qytetarët ushtrojnë kompetencat e tyre demokratike dhe ndërkulturore” (fq. 17) Për shembull, qytetarët që janë në gjendje dhe kanë dëshirë të marrin pjesë në vendimmarrje, kanë nevojë për qasje në informacione të pacensuruara të medias dhe kanë nevojë për kanale nëpërmjet të cilave ata mund të komunikojnë me njëri-tjetrin dhe me politikbërësit.
4. Ekziston një grumbull i dytë faktorësh në nivel makro që mund të prodhojnë “modele sistematike të disavantazhit dhe diskriminimit” (fq. 18) ashtu që qytetarët që kanë nivele të barabarta të kompetencave demokratike dhe ndërkulturore përballen me mundësi të pabarabarta për t'i ushtruar ato dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje. Pabarazia sociale mund të shfaqet për shkak të shpërndarjes së pabarabartë të të ardhurave, kohës së disponueshme, qasjes në rrjetet e informacionit ose të komunikimit dhe burimeve të energjisë. Shpërndarja e pabarabartë e burimeve brenda shoqërive lidhet me sistemin ekonomik (p.sh. paga e pabarabartë, papunësia, fuqia e ndërmarrjeve ndërkombëtare) dhe/ose sistemin politik. Ndarjet midis grupeve të privilegjuara dhe të pafavorizuara mund të nxisin çështje të pabarazisë gjinore, varfërisë, migrimit, arsimimit ose kontrollit të pushtetit. “Margjinalizimi sistematik dhe përjashtimi nga proceset demokratike dhe shkëmbimet ndërkulturore” (fq. 18) mund t'i privojë shumë qytetarë që të marrin pjesë në kushte të barabarta, pavarësisht nga nivelet e tyre të kompetencave,

duke rezultuar në “mosangazhim dhe tjetërsim qytetar” (ibid.).

5. Nëse nuk trajtohet në mënyrë adekuate, pabarazia sociale mund të perceptohet si e padrejtë dhe mund të kërcënojë kulturën demokratike dhe legjitimitetin e kuadrit institucional të demokracisë. Prandaj është me rëndësi që në komunitetet demokratike të adresohen çështjet e pabarazisë dhe përjashtimit social, për të siguruar “barazi të vërtetë të gjendjes” (ibid.) për të gjithë qytetarët. Me këtë që u tha, është e rëndësishme të kujtojmë se drejtësia shpërndarëse, ose të drejtat e njeriut dhe ato civile janë arritje historike që po zënë vend për një periudhë të gjatë kohore, siç tregon lufta për votën universale dhe të drejtat e grave në të gjithë Evropën. Të drejtat e njeriut dhe pjesëmarrja demokratike janë zhvilluar në një proces të gjatë që ende vazhdon. Për këtë arsye angazhimi i qytetarëve kompetentë është vendimtar për të siguruar që të gjithë anëtarët e shoqërisë, pavarësisht nga statusi i tyre shoqëror, gëzojnë njohje dhe mundësi të barabarta për pjesëmarrje.
6. Koncepti i kulturës: “Çdo kulturë e dhënë mund të konceptohet se ka tri aspekte kryesore: burimet materiale që përdoren nga anëtarët e grupit (p.sh. mjetet, ushqimet, veshjet), burimet e përbashkëta shoqërore të grupit (p.sh. gjuha, feja, rregullat e sjelljes shoqërore) dhe burimet subjektive që përdoren nga anëtarët individualë të grupit (p.sh. vlerat, qëndrimet, besimet dhe praktikatat të cilat anëtarët e grupit zakonisht i përdorin si kuadër të referencës për ta kuptuar dhe për të bërë lidhjen me botën). Kultura e grupit është një përbërje e krijuar nga të trija aspektet - ajo përbëhet nga një rrjet burimesh materiale, sociale dhe subjektive”. (fq. 19). Megjithatë, grupet kulturore janë heterogjene brenda vetit. Kulturat dhe normat janë të diskutueshme dhe ndryshojnë me kalimin e kohës. Anëtarët individualë në një grup kulturor bëjnë zgjedhjet e tyre në miratimin e elementeve të caktuara të burimeve kulturore dhe refuzimin e të tjerave.

Çdo grup social mund të ketë kulturën e vet të dallueshme. Këto grupe përfshijnë kombet, grupet etnike ose fetare, qytetet, lagjet, organizatat e punës, grupet profesionale, komunitetin LGBT, grupet e aftësisë së kufizuar ose gjeneratave dhe familjet. Prandaj, shoqëritë janë kulturalisht diverse, me individë të cilët në mënyrë të njëkohshme u përkasin grupeve të ndryshme shoqërore dhe marrin pjesë në konstelacione të kulturave, në mënyrë të ndryshme dhe individualisht unike. Brenda një grupi kulturor, individët dallojnë në pozicionimin kulturor, gjë që është arsyeja pse burimet kulturore janë të diskutueshme brenda grupeve kulturore.

Në çdo situatë ku njerëzit ndërveprojnë me njëri-tjetrin, ata mund të perceptojnë dallimet në kulturën e personit ose grupit tjetër, kështu që “çdo situatë ndërpersonale është potencialisht një situatë ndërkulturore” (fq. 20). Kuadri jonë i referencës pra mund të zhvendoset nga individuale dhe ndërpersonale në atë ndërkulturore, që do të thotë se ne i perceptojmë të tjerët si anëtarë të një grupi social më shumë sesa si individë. Situata të tilla ndërkulturore mund të lindin kur takojmë njerëz nga vende të ndryshme ose grupe etnike, besime të ndryshme, gjini, orientim seksual ose klasë shoqërore, ose vërejmë dallime në arsim. Dialogu ndërkulturor ka potencialin për të ndërtuar ura mes grupeve kulturore, me kusht që të zbatohet si një “shkëmbim i hapur i pikëpamjeve, në bazë të mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellë, ndërmjet individëve ose grupeve që e perceptojnë veten të kenë përkatësi të ndryshme kulturore nga njëri-tjetri.” (fq. 20 e tutje.)

Dialogu ndërkulturor është i rëndësishëm më të madhe për ta forcuar kohezionin social në shoqëritë demokratike kulturalisht diverse. Megjithatë, nëse grupet kulturore e perceptojnë njëri-tjetrin si armiq, për shembull për shkak të konfliktit të armatosur në të kaluarën, ose një grup kulturor perceptohet si i privilegjuar në kurriz të tjetrit, dialogu ndërkulturor mund të provohet të jetë shumë i vështirë, duke kërkuar një nivel të lartë të kompetencës ndërkulturore, ndjeshmëri, forcë dhe kurajo personale (shih fq. 21).

7. Koncepti i kompetencës dhe kompetencave: (fq. 23 e tutje) Në modelin e kompetencave për kulturë demokratike, koncepti i kompetencave (në shumës) i referohet “burimeve psikologjike” të një individi - vlerat, qëndrimet, aftësitë, njohuritë dhe/ose të kuptuarit kritik. Ne mund të imagjinojmë këto burime që t’i ngjajnë një kutie të madhe mjetesh me një shumëllojshmëri të gjerë të mjeteve mendore dhe psikologjike. Kompetenca (në njëjës) i referohet vullnetit dhe aftësisë së një personi që t’i vë në përdorim këto kompetenca ose mjete, siç konsiderohet adekuate në një situatë të caktuar, ose në trajtimin e një problemi. Koncepti i kompetencës ka kuptimin e një “procesi dinamik” (fq. 24) në të cilin një person përzgjedh, aktivizon, organizon dhe bashkërendon burimet psikologjike (kompetencat) në një situatë të caktuar, si dhe monitoron dhe përshtat vendosjen e kompetencave në varësi të kushteve. Kompetencat përdoren në grupe më shumë sesa veçmas. Kompetenca dhe kompetencat janë të

padukshme dhe të arritshme vetëm nëpërmjet teorive dhe modeleve. Ato janë të dukshme në sjelljen e një personi, me fjalë tjera atë që dikush bën, mendon, thotë, ose se si një person ndërvepron me të tjerët. Prandaj, mësuesit mund të vlerësojnë shkallën e zhvillimit të kompetencës së nxënësve të tyre duke vëzhguar sjelljen e tyre në situata demokratike ose ndërkulturore. Manuali mbi modelin e kompetencës për kulturën demokratike përshkruan tre shembuj për të treguar se si grupet e kompetencave mobilizohen në situata të caktuara: dialogu ndërkulturor, qëndrimi kundër gjuhës së urrejtjes dhe pjesëmarrja në debatin politik (shih fq. 24 e tutje).

8. Për të fuqizuar qytetarët e ardhshëm për të marrë pjesë në një kulturë të demokracisë në nivelin makro, fëmijët dhe të rinjtë duhet t'i mësojnë dhe t'i praktikojnë kompetencat për kulturë demokratike dhe dialog ndërkulturor në nivelin mikro të shoqërisë, në komunitetin e shkollës (shih fq. 16). Kjo kërkon që shkolla ta adoptojë Edukimin për Qytetari Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (EQD/EDNJ) si një qasje tërëshkolllore, që do të thotë mësimdhënie dhe të nxënësve lidhur me, përmes dhe për demokracinë dhe të drejtat e njeriut - ku demokracia dhe të drejtat e njeriut janë çështje e lëndëve mësimore ("lidhur me"), një udhëzues pedagogjik për të gjithë shkollën ("përmes"), dhe përgatitje për pjesëmarrje përmes përvojës praktike në shkollë ("për"). Për informatë më të plotë rreth tri përmasave të EQD/EDNJ shih <https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-1/part-1/unit-3/chapter-1/>. Mësuesit dhe drejtorët duhet të fitojnë kompetenca për kulturë demokratike dhe t'i praktikojnë ato në shkollë për të ofruar modele sjelljeje për nxënësit e tyre. Diversiteti në shoqëri pasqyrohet në komunitetin e shkollës dhe në klasë, kështu që dialogu ndërpersonal midis mësuesve dhe nxënësve, dhe midis nxënësve gjithmonë përfshin përmasën e dialogut ndërkulturor. Të nxënësve për kulturën demokratike nuk do të mjaftojë për ta ndryshuar për të mirë tërë shoqërinë në nivelin makro, por pa qytetarë kompetentë do të jetë e pamundur.

Të nxënit

Lidhja e mësimeve me botën reale

Drejtimi i një shkolle është detyrë kërkuese për një drejtor, duke kërkuar që ju të keni një ide të qartë për objektivat kyçe të institucionit tuaj. Ka mënyra të mira për të lidhur çështje të ndryshme dhe ka hapa të vegjël si copa të një enigme në një tablo të madhe. Të pasurit parasysh të kësaj tabloje të madhe, shpesh do t'ju ndihmojë të jeni të përgatitur për befasi, kryesisht të padëshiruara, para se ato të ndodhin.

“Pjesëmarrja demokratike për nxënësit duhet të kufizohet në këshillat e nxënësve dhe marrjen me aktivitetet në shkollë, por jo në klasë. Mësimet janë shumë të rëndësishme që nxënësit të ndërhyjnë në to.”

Kjo pikëpamje është e zakonshme në shkolla dhe njerëzit që argumentojnë në këtë mënyrë presin që nxënësit thjesht të vihen në rresht, duke iu bindur rregullave të shkollës dhe urdhrave nga stafi. Por nga ana tjetër, presim që nxënësit të përgatiten për rolin e tyre si qytetarë të rritur në një komunitet demokratik. A besojmë me të vërtetë se nxënësit disi vetë do të zhvillohen në qytetarë demokratikë, thjesht duke ndjekur shkollën disa vjet?

“A do të më duhet ndonjëherë kjo në jetën time, atje në botën reale? Pse më duhet?” Pyetjet si këto tregojnë hendekun midis kohës që nxënësit e kalojnë në klasë dhe jashtë klasës. Nxënësit nuk do të kënaqen me argumentin se një mësim është i dobishëm sepse ai është vendosur në kurrikulë nga ministria, ose sepse mësuesi thotë kështu, ose sepse i përgatit ata për teste. Përkundrazi, këto pyetje u kujtojnë mësuesve domethënien e didaktikës: Ata duhet të jenë në gjendje t'i shpjegojnë zgjedhjet e tyre të temave dhe rezultatet e të nxënit, duke pasur parasysh se diçka bëhet interesante nëse është e lidhur me jetën reale dhe me atë që nxënësit tashmë e dinë.

Nëse dëshironi ta diskutoni këtë temë me mësuesit tuaj, këto materiale do t'ju mbështesin:

Mësuesit mund të ndërmarrin hapa të vegjël nëse dëshirojnë t'iu përgjigjen nevojave të të nxënit të nxënësve, por duhet t'i ndërmarrin ata hapa: <https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-1/part-2/unit-1/chapter-2/lesson-7/>

Mësuesit që dëshirojnë të reflektojnë mbi zgjedhjet e tyre didaktike do të gjejnë mbështetje këtu: <https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-1/part-2/unit-2/>

Qytetaria demokratike mund të mësohet në shkollë përmes përvojës dhe reflektimit. Edukimi për qytetarinë demokratike dhe të drejtat e njeriut (EQD/EDNJ), si një temë në klasë dhe si një qasje tërëshkolllore, tregon shumë mënyra se si të lidhen temat mësimore me botën reale dhe veçanërisht me jetën në shkollë. EQD/EDNJ sugjeron rrugë të ndryshme që i përshtaten stileve të ndryshme të mësimdhënies. Për mësuesit që preferojnë kurse të përqendruara në mësuesit, EQD/EDNJ ofron ushtrime për tema dhe shembuj që lidhen me përvojën e nxënësve. Mësuesit e interesuar në modelet e të nxënit në bashkëpunim dhe atyre të bazuara në detyra do të gjejnë materiale të bollshme në manualët e EQD/EDNJ (<https://www.living-democracy.com/sq/teachers/>).



Të nxënit

Vlerësimi është shumë më shumë se testimi dhe kontrollimi

Vlerësimi duket si fundi i një gare. Vlerësimi duket si rrahjet e zemrës së një trupi të gjallë. Ky proces mund ta bëjë rolin tuaj si drejtor një makth ose mund t'ju ofrojë një mjet të përshtatshëm. Si pothuajse çdo gjë tjetër në shkollë, kjo është një çështje që ka nevojë për vëmendje serioze shumë kohë përpara provimeve përfundimtare.

Testimi nuk është vlerësim

Mësimdhënësi hyn në klasë. Ai/ajo e paraqet temën, nënvizon pjesët dhe faktorët e rëndësishëm, shpjegon atë që mendon se duhet shpjeguar dhe jep një ose dy shembuj. Nxënësi dëgjon dhe ndjek ritmin e mësuesit. Ai/ajo shkon në shtëpi, e gjen temën në tekst, lexon për temën, nënvizon pjesët e rëndësishme, kujton shpjegimin dhe zgjidh një ose dy ushtrime. Gjatë orës tjetër mësimore, mësuesi u kërkon nxënësve të përsërisin një pjesë të temës së dhënë. Në fund, ai/ajo i formulon pyetjet rreth elementeve të të gjithë materialit dhe pret që ata t'u përgjigjen në formë të shkruar. Dikush më jep diçka, unë merrem me të dhe ia kthej. Dhënësi e kontrollon atë për saktësi. Sipas pjesëve që mungojnë, ai/ajo i zbrit notat ekuivalente.

Ky është një vlerësim përmbledhës, që fokusohet në të arriturat e të nxënit, të cilin ne të gjithë e dimë nga testimi dhe notimi. Ky lloj i vlerësimit kërkohet në sistemet tona të shkollës për të kaluar një nivel të caktuar. Është gjithashtu një mjet kontrolli, por jo i vlerësimit, pasi mat efektivitetin e mësimdhënies si një mënyrë për t'u transformuar dhe për të dhënë informacion.

Testimi dhe kontrolli kanë dobësi serioze. Kriteret e vlerësimit janë shpesh ose shumë të paqarta, kështu që nuk mund të japin matje të drejta, ose shumë të përcaktuara, kështu që nuk mund të mbajnë llogari për diversitetin e fuqive dhe dobësive të nxënësve. Nëse marrim parasysh edhe subjektivitetin e personit që gjykon performancën e nxënësve, atëherë e njëjta arritje mund të marrë nota krejtësisht të ndryshme dhe informata kthyesë për nxënësin do të jetë pothuajse e padobishme.

Vlerësimi formativ dhe parashikues.

Jo vetëm në EQD/EDNJ, por në mësimdhënien e mirë në përgjithësi, vlerësimi gjithashtu i merr parasysh nxënësit individualë dhe proceset e tyre të të nxënit (vlerësimi formativ) dhe cilat rezultate mund të priten (vlerësimi parashikues). Këto forma të vlerësimit pasqyrojnë personalitetet e nxënësve, përparësitë e tyre të veçanta dhe nevojat e të mësuarit.

Kriteret e vlerësimit janë mjete për të analizuar gabimet e nxënësve individualë, më shumë sesa për t'i korrigjuar ato. Mësimdhënësit diskutojnë me nxënësit se si t'i kapërcejnë vështirësitë e tyre dhe nxënësit marrin përgjegjësinë për përparimin e tyre në mësim. Në këtë mënyrë, vlerësimi formativ dhe parashikues e lidh mësimdhënien dhe të nxënit me vlerat demokratike, duke u dhënë mundësi dhe inkurajuar nxënësit të marrin pjesë në demokraci dhe të jenë të suksesshëm në studimet e tyre të mëtutjeshme.

Për informata më të detajuara mbi vlerësimin përmbledhës, formativ dhe parashikues, shihni <https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-1/part-2/unit-5/chapter-2/lesson-3/>.

Informimi i nxënësve për kriteret e vlerësimit

Vlerësimi, prandaj, duhet të jetë pjesë e etikës demokratike të një shkolle. Nga kjo rrjedh se në një vlerësim përmbledhës, kriteret duhet të jenë të drejta dhe të qarta dhe ato duhet të jenë transparente për nxënësit. Kjo jo vetëm që i shërben edukimit për qytetarinë demokratike dhe të drejtat e njeriut, por gjithashtu është parakusht për mësimdhënie të mirë - në të gjitha lëndët. Për më tepër, ju dhe stafi juaj duhet të diskutoni dhe të pajtoheni për shtrirjen e vlerësimit. Për shembull, a përqendrohet vetëm në njohuri dhe shkathtësi, ose a përfshin gjithashtu qëndrime dhe vlera?

Vetëvlerësimi i mësuesve

Mësuesit nuk mund të ikin nga perspektivat e tyre individuale dhe ndikimi që këto kanë në vlerësimin e nxënësve të tyre. Kështu, ata duhet të jenë të vetëdijshëm se dallimet në vlerësim nga njëri mësues në tjetrin mund të jenë të padrejta për nxënësit individualë. Mësuesit duhet të reflektojnë në mënyrë të përhershme mbi procedurat e tyre të vlerësimit, gjë që mund të bëhet nëpërmjet vëzhgimit të kolegëve dhe ndarjes së informatave kthyesë

me njëri-tjetrin. Një metodë tjetër është marrja e informatave kthye nga nxënësit. Një qasje e tretë është vetëvlerësimi. Vëllimi i parë i manualëve të EQD/EDNJ për mësuesit “Edukimi për demokracinë”, përmban një kapitull të plotë mbi vlerësimin e nxënësve, mësuesve dhe shkollave, <https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-1/part-2/unit-5/>, dhe gjithashtu përfshin një listë kontrolli për vetëvlerësimin e mësimeve: <https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-1/part-2/unit-5/chapter-2/lesson-8/>



Të nxënit

Njohja dhe të kuptuarit e llojeve të ndryshme të diversitetit në shkollë

Diversiteti midis nxënësve tuaj është një sfidë e madhe për shkollën tuaj. Nëse kjo çështje nuk trajtohet në mënyrë adekuate, mund të ndikojë në arritjet e nxënësve dhe statusin e tyre shoqëror në jetën si të rritur. T'i sigurosh secilit nxënës një rast të barabartë për sukses në shkollë do të thotë t'i kuptosh nevojat e të nxënit të çdo nxënësi dhe t'u përgjigjesh atyre nevojave individualisht. Drejtësia në arsim nuk nënkupton që secilit t'i ofrojmë të njëjtën gjë, por t'i ofrojmë secilit atë që ka nevojë.


Por si mundeni ju, si drejtor, të merreni me diversitetin në shkollën tuaj pa staf të specializuar dhe pa kohë për të bërë kërkim për këtë? Një mënyrë është që të merreni me çdo rast që vjen në zyrën tuaj. Një mënyrë tjetër është përgatitja e personelit arsimor për të qenë të ndjeshëm ndaj diversitetit.

Kur flasim për diversitetin në shkollë, zakonisht mendojmë për dallimet kulturore mes nxënësve. Supozohet gjerësisht se diversiteti prek kryesisht shkollat me një sfond multikulturor mes nxënësve.

Ky supozim është provuar të jetë i gabuar. Hulumtimet kanë treguar se zakonisht ka më shumë dallime në mes të nxënësve që janë të etiketuar me identitete "të njëjta" kulturore, se sa me "të ndryshme". Diversiteti në shkollë nuk është kryesisht një çështje e përkatësisë kulturore apo etnike. Brenda çdo grupi kulturor ose etnik të nxënësve, do të gjejmë performues të mirë dhe të dobët dhe nxënës me nevoja të ndryshme të të nxënit.

Për t'u marrë me këtë lloj diversiteti në shkollë, personeli duhet të jetë i vetëdijshëm dhe i hapur ndaj llojshmërisë së karaktereve të nxënësve, stileve të të nxënit, gjinive, grupmoshave, nevojave zhvillimore, etj.

Megjithëse duket shumë e dëshirueshme të dihet profili specifik i të nxënit i çdo nxënësi, kjo nuk është e mundshme. Shkollat nuk kanë personel të specializuar, dhe mësuesit e drejtorët nuk kanë mjaft kohë për këtë. Por kultura e shkollës duhet ta inkurajojë qasjen e hapur ndaj diversitetit, në mënyrë që mësuesit ta marrin në konsideratë diversitetin në klasat e tyre, kur planifikojnë dhe zbatojnë mësimdhënien e tyre dhe kur vlerësojnë nxënësit e tyre.



Të nxënësit

Shkolla si komunitet i të nxënësit

Aktiviteti 1

Kjo është ajo që më pëlqen

Bazuar në vëllimin II të “Demokracia në veprim”, “Të rriturit në demokraci” fq. 18, 113;

<https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-2/unit-1/lesson-1/>

<https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-2/students-manual-10/student-handout-1/student-handout-2/>

Ky ushtrim mund të përdoret në një sesion trajnimi brenda shkollës për të gjithë personelin ose grupe të vogla mësuesish. Diskutimi pas aktivitetit (debrifingu) mund të çojë te pyetjet ose sugjerimet për tema të tjera në trajnimin në shërbim të mësuesve. Nëse marrin pjesë më shumë se 30 mësues, sugjerojmë krijimin e nëngrupeve që ndajnë rezultatet e tyre në një seancë plenare të mëvonshme.

Objektivat e të nxënësit	Mësuesit zbulojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre të ndërsjella mbi mësimdhënien.
Detyrat	Mësuesit përshkruajnë preferencat dhe zgjedhjet e tyre të mësimdhënies në katër kategori. Ata ndajnë përgjigjet e tyre me mësuesit e tjerë dhe reflektojnë mbi to.
Burimet	Letër dhe lapsa, kopje të shtypura të fletëve të punës (“Çfarë më pëlqen dhe çfarë bëj në mësimdhënie”)
Metodat	Punë individuale dhe në grup, diskutim plenar

- Grupit i paraqitet pyetja: Cilat stile të ndryshme të mësimdhënies i di?
- Pas një stuhie mendimesh fillestare dhe mbledhjes së përgjigjeve, anëtarëve të grupit u jepen fletët e punës. Ata punojnë me to në dy hapa:
 - Duke përdorur gjysmën e epërme të fletës së punës, ata i shënojnë përgjigjet e tyre nën katër kategoritë.
 - Pastaj, ata ecin rrotull, duke diskutuar preferencat dhe zgjedhjet e tyre me pesë kolegë dhe shkruajnë përgjigjet e tyre në pjesën e poshtme të fletës së punës.
- Në takimin plenar, mësuesit ulen në rreth. Diskutimi i tyre mund të udhëhiqet nga pyetjet në vijim:
 - Çfarë mendoni për përgjigjet e kolegëve tuaj? A u befasuat?
 - A shihni ndonjë ide të përbashkët në gjërat që kolegët tuaj pëlqejnë, por nuk i bëjnë?
 - Çfarë ndodh nëse dikush nuk di për gjërat që ju pëlqejnë t’i bëni dhe i bëni?
 - Çfarë ndodh nëse dikush nuk di për gjërat që nuk ju pëlqen t’i bëni, por i bëni?
 - Cili është rezultati i mundshëm praktik i këtij aktiviteti?

Aktiviteti 2

Ndërmarrja e hapave drejt shkollës si komunitet i të nxënit

Vëllimi I i serisë së manualëve për mësuesit në EQD/EDNJ, *Edukimi për demokraci*, fq. 83 - 92, përfshin kapitullin Udhëzimi për proceset e të nxënit dhe zgjedhja e formave të mësimdhënies. Ky është një mjet i dobishëm teorik dhe praktik për ata që duan ta zhvillojnë shkollën si një komunitet të të nxënit. Fleta e punës 3 (fq. 89), "Përzgjedhja e metodave të përshtatshme të mësimdhënies dhe të nxënit", përmban pyetjet kyçe për këtë çështje: <https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-1/part-2/unit-4/chapter-2/lesson-3>

Secili mësues e pranon një kopje të fletës së punës 3.

1. Punë individuale: secili mësues studion fletën e punës dhe zgjedh tri pyetje që i duken veçanërisht interesante.
2. Punë në grup: mësuesit ndajnë rezultatet e tyre dhe pajtohen për tri pyetje.
3. Punë në grup: për t'iu përgjigjur pyetjeve që kanë zgjedhur, mësuesit krijojnë një poster me dy propozime të veçanta se si ta përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënit në shkollën si komunitet i të nxënit.



Fleta e punës

Çfarë më pëlqen dhe çfarë bëj në mësimdhënie				
	Më pëlqen të bëj dhe bëj	E bëj, por nuk më pëlqen ta bëj	Nuk më pëlqen ta bëj, por e bëj	Nuk e bëj, por do të më pëlqente ta bëj
1				
2				
3				
4				
5				

Çfarë u pëlqen mësuesve të tjerë dhe çfarë bëjnë në mësimdhënie				
	Më pëlqen të bëj dhe bëj	E bëj, por nuk më pëlqen ta bëj	Nuk më pëlqen ta bëj, por e bëj	Nuk e bëj, por do të më pëlqente ta bëj
1				
2				
3				
4				
5				

Të nxënit

Kultura e të nxënit

Objektivat e të nxënit	Të punohet në përkufizimin e të nxënit dhe të lidhet ai me të nxënit rreth demokracisë në shkollë
Detyrat	Mësuesit vijnë te një definim i përbashkët i të nxënit dhe e zbatojnë atë në klasë dhe jashtë saj
Burimet	Letra dhe lapsi, fleta e punës
Metodat	Punë individuale dhe në grup, diskutim plenar

Llojshmëria është e mirë, por ajo është më mirë në sintezë. Është thelbësore të pajtohemi për një përkufizim të përbashkët të të nxënit. Është edhe më mirë që në këtë të përfshijmë, sa më shumë aspekte të ndryshme që mundemi. Ju dhe stafi juaj jeni persona të ndryshëm, siç kemi të drejtë të gjithë të jemi. Pra, për ta përdorur këtë të drejtë për dobinë demokratike të shkollës, ne duhet të arrijmë në një përkufizim të përbashkët, të pranuar, të pasur dhe të zbatueshëm të të nxënit.

Në Demokracia në Veprim, Vëll. IV, *Pjesëmarrja në demokraci*, fq. 159-151, <https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-4/part-2/unit-6/lesson-1/>, mësimi 1, “*Problemi ynë më urgjent është...*”, është një diskutim për vendosjen e agjendës politike. Ju mund të përdorni metodën “Muri i heshtjes” të përshkruar atje, duke riformuluar pyetjen kryesore, “Sipas mendimit tim, të nxënit është” dhe të modifikoni tabelën në faqen 150. Kjo metodë është e përshtatshme për 25 ose 30 pjesëmarrës, kështu që nëse marrin pjesë më shumë mesimdhënës, ndani ata në nëngrupe.

Detyra kërkimore në faqen 161 mund të shërbejë gjithashtu për të formuar grupe që kanë interesime të njëjta ose të ngjashme në aspekte të caktuara të të nxënit. Në këtë mënyrë, ju mund të nisni një bashkëpunim midis anëtarëve të stafit tuaj.



Të nxënit

Modeli i Këshillit të Evropës i kompetencave për kulturë demokratike (KKD)

Objektivat e të nxënit	<ol style="list-style-type: none"> Mësimdhënësit janë të njohur me modelin e kompetencave për kulturën demokratike. Ata janë të vetëdijshëm se kultura demokratike dhe dialogu ndërkulturor janë të lidhura ngushtë dhe janë objektiva kyçe në Edukimin për Qytetari Demokratike (EQD). Ata e kuptojnë se arsimimi në shkolla është çelësi për nxënësit që të fitojnë kompetencat që u duhen për të marrë pjesë në kulturën demokratike, si në shkollë ashtu edhe në jetën si të rritur.
Detyrat	<ol style="list-style-type: none"> Mësimdhënësit studiojnë diagramin dhe shënimet mbi modelin e KKD. Ata lexojnë kapitujt e zgjedhur nga manuali i KKD-së, ua prezantojnë njëri-tjetrit dhe i diskutojnë ato. Mësuesit shqyrtojnë me vëmendje edukimin për qytetari demokratike dhe të drejtat e njeriut si një qasje tërëshkollë, duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta. Së bashku me drejtorin dhe zëvendësit, ata diskutojnë një program për zhvillimin e shkollës dhe identifikojnë nevojat e tyre në aspektin e të nxënit dhe trajnimit.
Burimet	Një kopje për secilin pjesëmarrës: Këshilli i Evropës, Kompetencat për Kulturë Demokratike . „Kompetencat për Kulturë Demokratike: Diagram“
Metodat	Punë në grupe (metoda e ndërthurjes - Jigsaw), Diskutim
Komentet	<p>Është thelbësore që mësuesit ta kuptojnë se pse dhe për çfarë qëllimi duhet të angazhohen në zhvillimin e shkollës së tyre si një komunitet shkollor demokratik. Ne sugjerojmë, pra, një ditë trajnimi të brendshëm për të gjithë stafin e shkollës, përfshirë drejtorin dhe zëvendësit.</p> <p>Drejtori mund ta delegojë përgjegjësinë për përgatitjen dhe udhëheqjen e ditës së trajnimit të një ekipi mësimdhënësish. Në këtë rast, drejtori dhe zv.drejtorët mund të marrin pjesë në trajnim.</p> <p>Metoda e ndërthurjes u jep mësuesve mundësinë për t'ia shpjeguar modelin e kompetencave njëri-tjetrit (të nxënit e bazuar në detyra), kështu që nuk kërkohet ligjëratë. Secili pjesëmarrës merr përgjegjësinë për shpjegimin e një aspekti të modelit të KKD për kolegët e tij/saj dhe merr kontribute prej tyre në aspektet e tjera.</p> <p>Kjo ditë trajnimi mund të jetë një fillim për diskutime të mëtejshme, ngjarje trajnimi ose masa konkrete. Këshillohet që, në fund të ditës, drejtori të pajtohet me stafin për hapat konkretë.</p>

Një plan për një ditë të trajnimit të brendshëm për modelin e kompetencave për kulturë demokratike (KKD)

1. I Hyrje (sesion plenar); përafërsisht 20 minuta

- Qëllimi dhe objektivat e ditës së trajnimit
- Orari dhe afati kohor për fazat 1 - 3 (kjo është e rëndësishme për të siguruar që trajnimi të mund të përfundojë në kohën e disponueshme); vizualizimi (prezantimi në power point ose fletë të punës për pjesëmarrësit) ndihmon për të kursyer kohë.

- Çështjet teknike (p.sh. materialet) dhe organizimi
- Mësuesit janë caktuar në grupe studimi prej 6 anëtarëve; grupet dhe lokacioni i punës së tyre janë të shënuara në një tabelë.

2. Mësuesit e studiojnë dhe ia shpjegojnë modelin e KKD njëri-tjetrit (punë në grupe, metoda Jigsaw)

Faza 2.1: Dhënia e detyrave në grupet e diskutimit (A – DH); përafërsisht 30 minuta

- 36 mësime të ndarë në grupe me nga gjashtë anëtarë secili, me emërtimin A - DH. Nëse janë të pranishëm 72 ose më shumë pjesëmarrës, ata formojnë një rrjet të dytë me gjashtë grupe, të emërtuar E - H. Për t'iu përshtatur numrit të pjesëmarrësve, grupet e studimit mund të rriten deri në tetë pjesëmarrës.
- Grupet studiojnë diagramin me shënimet për modelin e KKD dhe diagramin “flutur” për kompetencat në [Kompetencat për Kulturë Demokratike](#), fq. 11
- Grupet caktojnë detyrat e mëposhtme, të numëruara 1 - 6, tek anëtarët e tyre:
 1. Shpjegoni konceptin e kulturës (shënimi 6, [Kompetencat për Kulturë Demokratike](#), kapitulli 3). Jepni një shembull të dialogut ndërkulturor në shkollën tuaj.
 2. Shpjegoni konceptin e kompetencës dhe kompetencave (shënimi 7, [Kompetencat për Kulturë Demokratike](#), kapitulli 4). Mendoni një shembull për të treguar se si grumbujt e kompetencave janë të mobilizuara në një situatë të caktuar.
 3. Shpjegoni rëndësinë e vlerave në modelin e kompetencave ([Kompetencat për Kulturë Demokratike](#) kapitulli 6, fq. 36 e tutje.) Zgjidhni një shembull për ta treguar rëndësinë e vlerave për kulturën demokratike dhe komunitetin e shkollës.
 4. Shpjegoni rëndësinë e qëndrimeve në modelin e kompetencave ([Kompetencat për Kulturë Demokratike](#), kapitulli 6, fq. 38 e tutje.) Zgjidhni një shembull për të treguar rëndësinë e qëndrimeve për kulturën demokratike dhe komunitetin e shkollës.
 5. Shpjegoni rëndësinë e aftësive në modelin e kompetencave ([Kompetencat për Kulturë Demokratike](#), kapitulli 6, fq. 43 e tutje.) Zgjidhni një shembull për të treguar rëndësinë e aftësive për kulturën demokratike dhe komunitetin e shkollës.
 6. Shpjegoni rëndësinë e njohurive dhe të kuptuarit kritik në modelin e kompetencave ([Kompetencat për Kulturë Demokratike](#), kapitulli 6, fq. 50 e tutje.). Zgjidhni një shembull për të treguar rëndësinë e njohurive dhe të kuptuarit për kulturën demokratike dhe komunitetin e shkollës.
 7. Nëse janë të pranishëm më shumë se 6 anëtarë të grupit, një detyrë u caktohet 2 anëtarëve të grupit të cilët do të punojnë si çift.

Faza 2.2: Përgatitja në grupe studimi (1 – 6); përafërsisht 45 – 60 minuta

- Pjesëmarrësit hyjnë në një grup studimi, të emërtuar prej 1 - 6. Në grupin 1, gjashtë pjesëmarrësit që kanë marrë detyrën 1 takohen për të përgatitur shpjegimet e tyre. Grupet e tjera të studimit fokusohen në detyrën 2 – 6, në të njëjtën mënyrë.
- Pjesëmarrësit studiojnë materialet që u janë caktuar atyre. Ata qartësojnë pikat që mund të jenë të vështira dhe përgatitin kontributin e tyre për grupet e tyre të diskutimit. Detyra e tyre është të informojnë, jo të gjykojnë ose të diskutojnë.
- Të gjithë pjesëmarrësit kanë përvojë të mësimdhënies, kështu që ata do të kuptojnë se kontributet e tyre duhet të mbahen të shkurtra dhe të thjeshta, për dy arsye: së pari, koha në dispozicion duhet të ndahet në mënyrë të barabartë për gjashtë kontributet; Së dyti, kohëzgjatja e vëmendjes e çdo pjesëmarrësi është e kufizuar.

Faza 2.3: Prezantimet në grupet e diskutimit (A – DH); përafërsisht 60 – 75 minuta

- Pjesëmarrësit kthehen në grupet e tyre të diskutimit.
- Me radhë, ata shpjegojnë aspektin e modelit të KKD që kanë zgjedhur. Ata respektojnë kohën në dispozicion për t'iu siguruar që çdo anëtar të mund të dëgjohet.
- Nëse lejon koha, pjesëmarrësit i ndajnë mendimet dhe përshtypjet për modelin e KKD.

3. Diskutimi në seancë plenare; për afërsisht 60 – 75 minuta

- Pjesëmarrësit mbledhen për seancë plenare.
- Pjesëmarrësit japin përshtypjet e tyre personale: çfarë m'u duk interesante ose e parëndësishme; çfarë do të doja të di më shumë; çfarë kam mësuar në lidhje me kompetencat e mia, etj. Këto deklarata nuk komentojnë ose diskutojnë para se të përfundojë radha e përshtypjeve. Pastaj, mund të pasojnë komentet dhe diskutimet.
- Pjesëmarrësit diskutojnë hapat e mëtejshëm të planifikimit ose veprimit, si në vijim:
 - Vlerësimi: kultura demokratike në komunitetin tonë shkollor: potencialet, përparësitë, dobësitë
 - Çfarë kontributi mund të jap, p.sh. si një shembull për t'u ndjekur për dialogun ndërpersonal dhe ndërkulturor?
 - Çfarë kontributi mund të jap në mësimdhënien time?
 - Cilat janë objektivat tona në mësimdhënie për të mbështetur kulturën demokratike?
 - Çfarë do të dëshironim për të mësuar dhe për t'u trajnuar?

Drejtori i dëgjon kërkesat dhe sugjerimet e mësuesve dhe më pas përgjigjet. Para se të mbyllet takimi, drejtori dhe stafi duhet të kenë rënë dakord për hapin tjetër ose hapat tjerë që do t'i marrin së bashku.



Të nxënit

Mësimdhënia si qasje tërëshkollore

Mësimdhënia së bashku (Demokracia në veprim Vëll. I, Edukimi për demokraci, fq. 108 e tutje.) <https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-1/part-2/unit-5/chapter-2/lesson-10/>

Përveç mësimdhënies në ekip, mësuesit janë të vetëm në klasat e tyre. Me kalimin e kohës ata mund të krijojnë vështirësi në ndërveprimin e tyre me nxënësit dhe këto mund të zbulohen vetëm nga vëzhgimet e kolegëve. Një mësues mund të ketë nevojë për mbështetje në punën e tij. Informatat kthyes nga nxënësit janë gjithnjë të dobishme, por informatat kthyes nga kolegët kanë një cilësi ndryshe, pasi kolegët përvetësojnë një perspektivë profesionale në një nivel të barabartë vështirimi. Për këtë arsye, mësimdhënësit shpeshherë janë të trembur nga hapja e klasave të tyre për kolegët vizitorë. Udhëzimi i mëposhtëm mund të ndihmojë që të inkurajohen mësuesit që të provojnë mbikëqyrjen kolegjiale (shih Demokracia në veprim Vëll. I, Edukimi për Demokraci, fq. 109 <https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-1/part-2/unit-5/chapter-2/lesson-11/>)

Madhësia e ekipit:	Tre mësues formojnë ekipin për informata kthyes mes kolegëve.
Organizimi:	Mësuesit vizitojnë njëri-tjetrit në klasë dy herë gjatë vitit shkollor, kështu që secili mësues vizitohet dy herë nga dy kolegë dhe ndjek katër orë mësimore si vëzhgues. Ekipet janë përgjegjëse për planifikimin e vizitave të tyre, duke marrë parasysh oraret dhe programet e tyre. Pas orës mësimore, mësuesi e ndan pikëpamjen e vet për orën mësimore dhe mësuesi vizitor jep informatën kthyes.
Lidhja me lëndën:	Mësuesit i vëzhgojnë mësimet e EQD/EDNJ të njëri-tjetrit. Nuk është e domosdoshme që të ligjërojnë edhe vet të njëjtën lëndë.
Përbërja e grupit:	Simpatia dhe besimi janë me rëndësi kur formohen ekipet për mbikëqyrje kolegjiale. Duhet të jetë e qartë se ajo çfarë shohin kolegët në klasë është konfidenciale.
Detyra e drejtorit:	Detyra e drejtorit është të përcjellë numrin minimal të vizitave brenda ekipit. Drejtori nuk duhet të përfshihet në diskutimet lidhur me çështjet e mësimdhënies.
Fokusi tematik:	Pyetjet që mund të jenë pika të fokusit të këtyre vizitave të kolegëve mund të lindin nga interesa ose marrëdhënie të ndryshme: a) një mësues dëshiron të marrë informata kthyes mbi një çështje të caktuar; b) një kurrikulë, metodë ose aktivitet i ri është prezantuar dhe duhet të vlerësohet; ose c) parimet pedagogjike (për shembull, të formuluar në programin ose profilin e shkollës) duhet të vlerësohen.



Të nxënit

Si mund të jetojnë njerëzit së bashku?

Objektivat e të nxënit	Të merret në konsideratë roli i edukimit në aftësimin për kompetencat për dialogun ndërkulturor (shih prospektin „ Kompetencat për Kulturë Demokratike: Diagram “)
Detyrat	Aktivitet në grup duke shfrytëzuar “ <i>Shkolla në skaj të pyllit</i> ”
Burimet	Vëll. III i EQD/EDNj, <i>Demokracia në veprim</i> , fq. 80 https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-3/part-1/unit-3/student-handout-5/
Metodat	Lojë me role, diskutim, hamendësim, të menduar kritik

Shih përshkrimin e njësisë mësimore në vëll. III të EQD/EDNj, *Demokracia në veprim*, fq. 66 – 68. <https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-3/part-1/unit-3/lesson-1/>



Të nxënit

Lidhja e të nxënit me botën reale: Verifikimi i objektivave të mia të mësimdhënies

Që të nxënit të jetë kuptimplotë, nxënësit duhet të jenë në gjendje t'i lidhin rezultatet e tyre të të nxënit me përvojën dhe interesat e tyre në jetën reale. Për këtë arsye, është e domosdoshme që mësuesit t'i kontrollojnë objektivat e tyre në qoftë se synojnë ta lidhin mësimdhënien e tyre me botën reale.

- Njohja me detyrën, qëllimin dhe fokusin e saj
- Mësimdhënësit me lëndët e njëjta apo të përafërta formojnë grupe.
- Shpërndani fletën e punës
- Lejoni kohë që anëtarët e grupit ta plotësojnë listën.
- Anëtarët e grupit diskutojnë përgjigjet e tyre.
- Sipas rëndësisë së tyre, ata u japin përparësi pyetjeve, duke i renditur ato me numra në çdo rresht.
- Grupet paraqesin tri prioritetet e para.
- Diskutimi përfundimtar, i udhëhequr nga pyetjet e mëposhtme:
 - A pajtohem për prioritetet tona?
 - Pse janë objektivat e të nxënit vendimtare për lidhjen e një mësimi me botën reale?
 - Sa e realizueshme është një listë e tillë në shkollën tonë?
 - Cilat janë pengesat kryesore në aplikimin e një liste të tillë në praktikën tonë të përditshme të mësimdhënies?

Fletë pune

Nga Demokracia në veprim, Vëll. I, *Edukimi për demokraci*, Detyra dhe pyetjet kyçe, faqe 67 – 68 <https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-1/part-2/unit-2/chapter-2/>


Çfarë objektivash dëshiroj t'i arrij?	
Cilat kompetenca do të jenë më të rëndësishmet për t'u arritur në fund të njësisë?	
Çfarë arsyes mund të jap për përzgjedhjen e këtyre objektivave?	
Çfarë prioritetesh u jap objektivave të mia (objektivat parësore dhe ato dytësore)?	
Cilat objektiva janë të rëndësishme tani – për klasën si tërësi, për nxënësit individualë, djem dhe/ apo vajza?	
A jam siguruar se objektivat që kam përzgjedhur do t'u shërbejnë interesave dhe nevojave kryesore të nxënësve të mi?	
A i përgjigjen mësimet e mia me të vërtetë asaj për të cilën nxënësit e mi merakosen?	
A është e mundur që nxënësit të marrin pjesë në përcaktimin ose përzgjedhjen e objektivave të të nxënësve?	
Sa kohë (orë mësimore dhe javë) është caktuar për arritjen e objektivave?	
Cilat objektiva duhet të arrihen nga të gjithë nxënësit brenda kohës së mësimin në dispozicion (standardi i arritjeve)?	
A duhet të përcaktohen nivele të veçanta arritjesh për nxënës individualë (arsimimi sipas aftësisë individuale)?	
A i kam aftësuar unë nxënësit që të kalojnë nga njohuritë në veprime, domethënë, a mundën ata t'i zbatojnë me vetëbesim njohuritë që kanë fituar?	
Ku përqendrohem unë në mësimdhënien time – në kompetencën njohëse, personale apo sociale?	
A kam një ide të qartë për objektivat afatshkurtra dhe afatgjata, të cilat janë të një rëndësie parësore për klasën time, për grupet e të nxënësve individualisht, djem e vajza?	
A i kam deklaruar qartë dhe shprehimisht objektivat?	

Të nxënit

Vlerësimi karshi testimit dhe kontrollit

Standardet e referimit

- Kërkojuni mësuesve të sjellin me vete një vlerësim të nxënësit, sipas rastit (nota, test, etj);
- Mësuesit formojnë grupe. Shpërndani fletën e punës 1;
- Mësuesit e studiojnë fletën e punës (punë individuale);
- Në grupe, ata krahasojnë cilat standarde të referencës zakonisht i marrin në konsideratë dhe cilat nuk i përdorin;
- Ata diskutojnë realizueshmërinë dhe vlerën e të vlerësuarit sipas kriterëve të paraqitura në fletën e punës 1.
- Shpërndani fletën e punës 2;
- Anëtarët e grupit i përgjigjen pyetësorit;
- Ata kontrollojnë vlerësimin e tyre duke përdorur fletën e punës 2;
- Diskutim rreth pikave të forta dhe të dobëta në vlerësim.



Fletë pune 1

(bazuar në Demokracia në veprim, Vëll. I, *Edukimi për demokraci*, fq. 101)

<https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-1/part-2/unit-5/chapter-2/lesson-4/>

Ekzistojnë tri standarde të ndryshme themelore të referencës për vlerësimin dhe vënien e notave për arritjet e nxënësve:

1. Kriteri individual: arritjet aktuale të nxënësit krahasohen me punën e tij të mëparshme.
2. Kriteri objektiv: arritjet e nxënësit krahasohen me objektivat e të nxënët të përcaktuara paraprakisht.
3. Kriteri social: arritjet e nxënësit krahasohen me ato të nxënësve brenda të njëjtës klasë ose të njëjtës grupmoshë.

(Për më shumë informata për kriteret e lartshënuara, shih Demokracia në veprim, Vëll. I, *Edukimi për demokraci*, fq. 102) <https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-1/part-2/unit-5/chapter-2/lesson-5/>

Lloji i kriterit	Kriteri individual	Kriteri objektiv	Kriteri social
Figura referente	Progresi në të nxënë	Objektivi i të nxënët	Lakorja normale e shpërndarjes, mesatarja aritmetike, devijimi
Informacioni	Sa është nxënë në mes të kohës 1 dhe kohës 2?	Deri në ç'masë nxënësi i është afruar objektivit të të nxënët?	Sa i madh është devijimi i progresit individual prej mesatares?
Lloji i vlerësimit	Testet, vlerësimi me gojë, raporti i progresit të të nxënët, forma e strukturuar e vëzhgimit	Test i orientuar në qëllimi, forma e strukturuar e vëzhgimit	Testi përfshirë notën, i orientuar në mesataren e klasës
Implikimet pedagogjike	Shumë lart	Shumë lart	Përdoret shpesh për përzgjedhje; nuk është i rëndësishëm për orientim drejt përkrahjes së nxënësve

Fletë pune 2

(bazuar në Demokracia në veprim, Vëll. I, *Edukimi për demokraci*, fq. 103)

<https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-1/part-2/unit-5/chapter-2/lesson-6/>

Pyetjet për vetëvlerësim

Procesi i të nxënimit të nxënësve:

– Si mund të sigurohem se nxënësit i kanë arritur objektivat?	
– A kanë përjetuar nxënësit rregullisht suksesin gjatë të mësuarit?	
– A janë ata të vetëdijshëm për përparimin që kanë bërë?	
– A u ofron mësimdhënia ime djemve edhe vajzave mundësi të barabarta për sukses?	
– A e bëjnë nxënësit me vetëdije vëzhgimin, kontrollin dhe përmirësimin e të nxënimit të tyre dhe sjelljes së punës?	
– A u është ofruar nxënësve ndonjë udhëzim për t'i ndihmuar ata në të nxënë?	
– A munden nxënësit ta kontrollojnë dhe vlerësojnë vetë sjelljen e të mësuarit dhe rezultatet e tyre?	
– A u referohen nxënësit në vetëvlerësimin e tyre edhe objektivate, standardeve, kritereve ose nevojave të tyre?	
– A jam unë i vetëdijshëm për përparimin individual të nxënësve?	
– Si i identifikoj problemet e të nxënimit të nxënësve individualë?	
– Si e vëzhgoj ndërveprimin social në klasë?	
– Si e mbaj regjistrin e vëzhgimeve dhe vlerësimeve për nxënësit individualë dhe për klasën në tërësi?	
– ...	

Disa pyetje në lidhje me procesin e të nxënimit të mësuesit:

– Si, kur dhe me kë reflektoj rreth mësimdhënies sime?	
– Si i lejoj nxënësit e mi të marrin pjesë?	
– Si e ndërlidh suksesin ose dështimin e nxënësve të mi me mësimdhënien time?	
– Si e dalloj përparimin tim në mësimdhënie dhe si mësoj unë si mësues?	

Të nxënit

Mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar në vlera si parandalim i problemeve me sjelljet në shkollë

Aktiviteti 1

Lista kontrolluese personale e drejtorit për vlerat dhe shkollën

(bazuar në E. Bäckman/B. Trafford (2007) [Qeverisja demokratike e shkollave](#), Fusha kyçe 2: **Edukimi i bazuar në vlera – kontekstet informale**, fq. 50). Ky libër është i disponueshëm në ueb faqen e Këshillit të Evropës si pjesë e paketës së EQD/EDNJ

“Një shoqëri homogjene me vlera të përbashkëta, nëse ka ekzistuar ndonjëherë, është gjë e së kaluarës. Historikisht, shkollimi publik ka qenë gjithmonë vegël e atyre që kanë qenë në pushtet, për të përhapur vlera të caktuara të shtetasit e tyre. Kjo ende vazhdon të jetë kështu, por, në një shoqëri demokratike, vlerat që duam t’i transferojmë te gjeneratat e reja ndërtohen dhe mirëmbahen në mënyrë të hapur dhe përmes proceseve demokratike.”

[Qeverisja demokratike e shkollave](#), fq. 45



Qëllimet e mira në dokumentet e shkruara kanë vlerë të vogël nëse udhëheqësit dhe personeli i shkollës nuk demonstrojnë shpesh dhe në situata të përditshme, se deklaratat zyrtare vërtet tregojnë të vërtetën.

Pikëpamja personale	
<p>Hapi 1: Vlerat tuaja personale nuk janë të rëndësishme. Ju u besoni autoriteteve mbi ju. Vlerat nuk i konsideroni prioritet, përveç ndoshta stabilitetit, rendit dhe dëgjueshmërisë.</p>	<p>Provoni këtë: Pyeteni veten: cilët janë stimujt e mi? Çfarë shkolle dëshiroj? Çfarë shoqërie? Cilat vlera dëshiroj t'ua transferoj nxënësve të mi? (ose thjesht do të mund ta pyetni veten: pse dëshiroj të bëhem drejtor i shkollës?)</p>
<p>Hapi 2: Ju e keni të qartë se çka dëshironi në kuptim të vlerave të cilat duhet të jenë evidente në mësimdhënie dhe në jetën e përditshme në shkollë. Keni filluar gjithashtu t'i përhapni mendimet e juaja te njerëzit rreth jush.</p>	<p>Provoni këtë: Rritni ambiciet tuaja: ju dëshironi që e tërë shkolla t'i përqafojë të njëjtat vlera, prandaj harxhoni kohë dhe energji ta përhapni këtë mesazh. Ju gjithashtu i përfshini nxënësit në biseda formale dhe joformale për demokracinë, të drejtat e njeriut dhe respektin për të gjithë. Si gjithmonë, inkurajoni nismat e mira.</p>
<p>Hapi 3: Ju vërtet i gëzoheni aspekteve të reja të jetës, ashtu siç reflektohen në sjelljet dhe në vlerat e të gjitha palëve të ndryshme të shoqërisë që janë të përfaqësuar në shkollën tuaj. Angazhimi juaj personal është burim i inspirimit për nxënësit dhe për personelin.</p>	<p>Provoni këtë: Bëni që të gjithë ta kuptojnë fuqinë e shembujve të mirë. Mësimdhënësit dhe të rriturit e tjerë në shkollë duhet të bëhen thellësisht të vetëdijshëm për funksionin e tyre si model sjelljeje, ndërsa nxënësit më të rritur duhet ta dinë se i shërbejnë të njëjtit qëllim për nxënësit e moshës më të re.</p>

Të nxënit

Mësimdhënia si faktor i demokracisë

Objektivat e të nxënit	Mësuesit bëhen të vetëdijshëm për qëndrimet dhe praktikat që lidhen me diversitetin, dhe pranojnë njëri-tjetrin si pjesë të grupit. Ata bëhen të vetëdijshëm për diversitetin në mesin e nxënësve në shkollën e tyre duke vëzhguar sjelljen e tyre gjatë pushimeve. Ata reflektojnë mbi të dhënat që i kanë mbledhur dhe i analizojnë ato. Ata i lidhin perspektivat e hulumtimit cilësor dhe sasior
Detyrat	Mësuesit arrijnë të një përkufizim i përbashkët i të nxënit dhe e zbatojnë atë brenda dhe jashtë klasës. Ata i hulumtojnë kushtet e shkollës së tyre jashtë klasës. Ata punojnë me statistika dhe paraqesin rezultatet e tyre.
Burimet	Fletë dhe stilolapsa, fleta pune
Metodat	Punë individuale, punë në grup, diskutim plenar

Mësuesit e shkencës shpesh e kanë të vështirë të imagjinojnë qeniet e gjalla prapa shifrave dhe të dhënave. Anasjelltas, mësuesit e arteve kanë vështirësi të punojnë me shifra abstrakte që qëndrojnë për qeniet e gjalla. Në të dyja rastet ekziston një hendek midis rezultateve të të nxënit që këta mësues presin dhe jetës së vërtetë siç e përjetojnë nxënësit. Ky projekt kërkimor mbi jetën në komunitetin e shkollës ndihmon për ta kapërcyer hendekun ndërmjet perspektivave të hulumtimeve cilësore dhe sasore.

Rëndësia e temës së këtij projekti kërkimor është e lidhur ngushtë me edukimin për demokracinë dhe të drejtat e njeriut: Shoqëritë tona janë të ndryshme në aspektin kulturor dhe grupet kulturore formojnë shumicën dhe pakicën. Kjo strukturë pasqyrohet në identitetet e ndryshme të nxënësve në komunitetin e shkollës. Kur nxënësit ndërveprojnë me njëri-tjetrin, ndërveprimi ndërpersonal bart gjithashtu një dimension ndërkulturor, për shembull midis djemve dhe vajzave, por edhe përtej grupeve gjinore. Ndërveprimi dhe dialogu ndërkulturor janë thelbësore për një komunitet demokratik të shkollës.



Në Demokracia në veprim, Vëll. II, *Rritemi në demokraci*, fq. 36-40, mësimet 1 - 3 përqendrohen në ndërveprimin dhe dialogun ndërpersonal dhe ndërkulturor në komunitetin e shkollës. Mësimet janë të dizajnuara për nxënësit. Mos ndryshoni asgjë, thjesht përdorni ato në nivelin e të kuptuarit dhe reflektimit të mësuesve. Mos i lini jashtë mësimet 2 dhe 3. Ato përmbajnë një udhëzues për një proces të kërkimit cilësor dhe sasior dhe tregojnë një lidhje të mirë të jetës brenda dhe jashtë klasës.

<https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-2/unit-3/lesson-1/>

<https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-2/unit-3/lesson-2/>

<https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-2/unit-3/lesson-3/>

<https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-2/students-manual-10/student-handout-1/student-handout-11/>

<https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-2/students-manual-10/student-handout-1/student-handout-12/>

Për dialogun ndërkulturor si një element i qenësishëm në kulturën demokratike, si në shkollë ashtu dhe në shoqërinë në tërësi, shih fletën e punës "[Kompetencat për Kulturë Demokratike: diagrami](#)" dhe/apo [Kompetencat për kulturë demokratike](#), fq. 19 e tutje.

Të nxënit

Të njohurit dhe të kuptuarit e diversitetit në shkollë

Bëj një hap përpara (Aktivitet nga Kompasit, i modifikuar për mësues e edukatorë)

<https://www.coe.int/en/web/compass/take-a-step-forward> (në anglisht)

Objektivat e të nxënit	Të rritet ndërgjegjësimi dhe njohja e diversitetit në klasë dhe të rritet ndërgjegjësimi për pabarazinë e mundësive në komunitetin e shkollës.
Detyrat	Mësuesit, në rol të nxënësve, bëjnë një hap përpara sa herë që pajtohen me një deklaratë.
Burimet	Hapësirë e madhe (holl, sallë, hapësirë e jashtme), karta me role, muzikë
Metodat	Lojë me role, diskutim

- Krijoni një atmosferë të qetë me ca muzikë të lehtë në sfond. Ose, kërkoni pjesëmarrësve të heshtin.
- Dorëzoni kartat me role në mënyrë të rastësishme, një për çdo pjesëmarrës. Thuajuni që ta mbajnë atë për vete dhe mos t'ia tregojnë dikujt tjetër.
- Ftoni ata të ulen (mundësisht në dysheme) dhe ta lexojnë kartën e tyre me rol.
- Tani kërkoni nga ata që të fillojnë të hyjnë në rol. Për të ndihmuar, lexoni disa nga pyetjet e mëposhtme, duke ndaluar pas secilës prej tyre, për t'u dhënë njerëzve kohë për të reflektuar dhe për të ndërtuar një fotografi të vetes dhe të jetës së tyre: Si ishte fëmijëria juaj? Në çfarë shtëpie keni jetuar? Çfarë lojërash keni luajtur? Çfarë lloj pune kanë bërë prindërit tuaj?
- Le të ndjekim një ditë shkollë: Zgjedhim në shtëpinë time Gjithë ditën Gjëja e fundit para se të fle është të mendoj për të ardhmen time, shpresat e mia, frikën time...
- Tash kërkoni njerëzve që të mbeten absolutisht të heshtur ndërsa vihen në rresht pranë njëri-tjetrit (si në vijën e startit).
- Tregojuni pjesëmarrësve se do të lexoni një listë të situatave ose ngjarjeve. Çdo herë që ata mund t'i përgjigjen me "po" deklaratës, ata duhet të bëjnë një hap përpara. Përndryshe, ata duhet të qëndrojnë aty ku janë dhe të mos lëvizin.
- Lexoni situatat një nga një. Ndaloni për një kohë ndërmjet secilës deklaratë për t'u lejuar njerëzve kohë për të bërë një hap përpara dhe për të shikuar përreth për të parë pozicionet e tyre në krahasim me njëri-tjetrin.
- Në fund, ftoni të gjithë t'i regjistrojnë pozicionet e tyre përfundimtare. Më pas jepuni atyre disa minuta për të dalë nga roli i tyre para se të diskutojnë në seancë plenare.
- Diskutimi përmbledhës mund të udhëhiqet nga pyetjet e mëposhtme:
 - Si ndjeheshin njerëzit lidhur me të ecurit përpara - apo jo?
 - Për ata që bënë shpesh hapa përpara, në ç'pikë filluan të kuptonin se të tjerët nuk lëviznin po aq shpejt sa ata?
 - A ndihej dikush se kishte momente kur të drejtat e tyre themelore të njeriut po shpërfilleshin?
 - Sa i lehtë apo i vështirë ishte të luajturit e roleve të ndryshme?
 - Si e imagjinonin që ishte personi që ata po e luanin?
 - A mund t'i qëllonin rolet e njëri-tjetrit? (Lëri njerëzit t'i zbulojnë rolet e tyre gjatë kësaj pjese të diskutimit)
 - A e pasqyron ky ushtrim shoqërinë shkollë në një farë mënyre? Si?
 - Cilët janë hapat e parë që mund të ndërmerren për të adresuar pabarazitë në komunitetin e shkollës?


Këshilla për fasilitatorët

Nëse e bëni këtë aktivitet jashtë, sigurohuni që pjesëmarrësit të mund t'ju dëgjojnë, veçanërisht nëse jeni duke e bërë atë me një grup të madh. Ju mund të keni nevojë të përdorni bashkëpunëtorët tuaj për t'i transmetuar deklaratat.

Në fazën e të imagjinuarit në fillim, është e mundur që disa pjesëmarrës të thonë se nuk dinë shumë për jetën e personit që duhet ta personifikojnë. U thoni atyre se kjo nuk ka rëndësi dhe se ata duhet ta përdorin imagjinatën e tyre dhe ta luajnë atë sa më mirë që mundën.

Fuqia e këtij aktiviteti qëndron në ndikimin që e bën të vërejturit e distancës në rritje midis pjesëmarrësve, veçanërisht në fund kur duhet të ketë një distancë të madhe midis atyre që shpesh kanë bërë hapa përpara dhe atyre që nuk e kanë bërë këtë. Për të rritur ndikimin, është e rëndësishme që t'i përshtatni rolet për t'i pasqyruar realitetet e jetëve të pjesëmarrësve. Duke vepruar kështu, sigurohuni që t'i përshtatni rolet në atë mënyrë që vetëm një pakicë njerëzish të mund të bëjnë hapa përpara (pra, që mund të përgjigjen “po”). Kjo vlen edhe nëse keni një grup të madh dhe keni nevojë për më shumë role.

Gjatë diskutimit përmblyës dhe vlerësimit, është e rëndësishme për të shqyrtuar se si pjesëmarrësit dinin në lidhje me personazhin rolin e të cilit ata kishin për të luajtur. A ishte nëpërmjet përvojës personale apo përmes burimeve të tjera të informacionit (lajme, libra dhe shaka)? Sa të sigurtë janë ata që informacioni dhe imazhet që kanë për personazhet janë të besueshme? Në këtë mënyrë ju gjithashtu mund të paraqitni se si veprojnë stereotipet dhe paragjykimet.



Fletë pune

Ti je bija e një mësuesi të matematikës në shkollën tuaj	Disa nga mësuesit janë klientë në dyqanin e flokëtarisë të nënës sate
Babai yt është prift	Ti je bija e emigrantëve filipinas
Ti ke ardhur në vend nga India, shtatë vjet më parë	Prindërit e tu janë arkitektë
Babai yt që është doktor, dëshiron që edhe ti të bëhesh doktor	Prindërit e tu janë punëtorë në fabrikën e tekstitit
Ti jë i pari nga 5 fëmijët në familje. Babai yt punon në administratën komunale	Prindërit e tu janë shumë religjiozë
Ti je bija e një emigranti ekonomik nga Pakistani	Babai yt është pronar i një dyqani të madh të këpucëve
Prindërit e tu kanë qenë të papunë në gjashtë muajt e fundit	Prindërit e tu janë të ndarë, ata janë në gjykatë duke luftuar për kujdestarinë ndaj teje
Ti je biri i një prindi të vetëm	Prindërit e tu janë shkurorëzuar para 6 vjetëve. Nëna jote është mësuese e historisë
Familja jote ka ardhur nga Shtet e Bashkuara të Amerikës. Ju keni jetuar këtu që një vit	Ti je një vajzë rome. Jeton në kamp, 20 minuta larg shkollës
Ti je bija e një punëtori të ambasadës së Gjermanisë në vend	Ti je invalid. Sillesh rrotull duke lëvizur me karrocë
Ti je biri i parë i një familjeje hebreje	Babai yt punon në fabrikë, nëna jote nuk punon

Të nxënit

Në fillim apo në fund: Historia ime personale e edukimit

Ky aktivitet mund të funksionojë si aktiviteti i parë i gjithë serisë së paraqitur këtu, ose si përmbyllës, në fund të serisë. E vetmja gjë që ndryshon është diskutimi fillestar ose përmbyllës i veprimit.

Objektivat e të nxënit	Të identifikojnë lidhjet personale, pajtimet dhe kundërshtimet lidhur me edukimin
Detyrat	Mësuesit shqyrtojnë, identifikojnë dhe diskutojnë se si kanë mësuar gjatë gjithë jetës së tyre, çfarë vazhdojnë të mësojnë, cilat janë interesat e tyre dhe shkathësitë e tyre të veçanta, etj.
Burimet	Fleta e punës prej Demokracia në veprim, Vëll. I, faqe 58
Metodat	Punë individuale, diskutim plenar

- Shpërndani nga një kopje të fletës së punës tek çdo mësues.
- Jepni një afat kohor prej disa ditësh për mësuesit që të punojnë me të në mënyrë individuale dhe caktoni një datë për diskutim të përgjithshëm.
- Në datën dhe kohën e caktuar, mësuesit takohen për të ndarë dhe diskutuar gjetjet e tyre. Ata ose mund të punojnë së pari në grupe dhe pastaj të takohen në sesion plenar, ose të fillojnë t'i diskutojnë gjetjet e tyre në sesion plenar.
- Pikat e mëposhtme mund të ngrihen:
 - Nevojat për mësim dhe trajnim, p.sh. ekspertiza akademike, metodat e mësimdhënies, të kuptuarit e proceseve të të nxënit, etj;
 - Krahasimi dhe diskutimi i udhëzimeve të mësimdhënies në të cilat mësuesit mbështeten;
 - Masat për të zvogëluar stresin dhe për të përmirësuar efikasitetin në punën e përditshme;
 - Diskutimi i rëndësisë së të nxënit dhe mësimdhënies dhe lidhja me jetën e shkollës si një tërësi.

Në varësi të kontekstit, ky sesion shërben për të planifikuar veprimet e mëtejshme, duke u bazuar në përmbajtjen në këtë material, ose për të vlerësuar veprimet e ndërmarra deri më tani, dhe duke marrë në konsideratë hapat e mëtejshëm.



Fleta e punës (prej Demokracia në veprim, Vëll. I, Edukimi për demokraci, fq. 58)

<https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-1/part-2/unit-1/chapter-2/lesson-2-2/>

Si t'i marr parasysh aftësitë dhe njohuritë e mia të mësimdhënies

<ul style="list-style-type: none"> • Çfarë përvoja, njohurish dhe aftësish të përgjithshme kam unë?
<ul style="list-style-type: none"> • Në çfarë mase kanë nevojë të plotësohen njohuritë e mia, duke iu referuar çështjeve të përmbytjes së lëndës, objektivave, metodave të përshtatshme të mësimdhënies dhe proceseve të të mësuarit?
<ul style="list-style-type: none"> • Në cilat fusha dëshiroj të edukohem më tej (të njohurive të përgjithshme, metodave të mësimdhënies, aftësive profesionale, cilësive personale, rutinës, etj.)?
<ul style="list-style-type: none"> • Cilin koncept i natyrës njerëzore shërben si udhëzuesi im i përgjithshëm?
<ul style="list-style-type: none"> • Cili është kuadri teorik ose një variant i thjeshtuar i një teorie që udhëheq punën time si mësues?
<ul style="list-style-type: none"> • Si mund ta përshkruaj dhe klasifikoj marrëdhënien time me nxënësit?
<ul style="list-style-type: none"> • Cilët janë kufijtë e mi në lidhje me orët e punës, stresin, etj.? Si e shfrytëzoj unë kapacitetin tim personal të punës?
<ul style="list-style-type: none"> • Si ta pakësoj ngarkesën time të punës përmes një planifikimi më të mirë të punës dhe të veprimtarive të tjera?
<ul style="list-style-type: none"> • Si e përdor me efektshmëri kohën dhe si merrem me shkaktarët e stresit tim?